



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 249 Akti

Nr. 256 Vendimi  
Tiranë, më 12.6.2020

### V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hervatin, në datën 10.6.2019, ora 9:30, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Etleva Deda**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” të Aneksit të Kushtetutës;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Etleva Deda është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si gjyqtare në Gjykatën e Posaçme Kundër Krimin dhe Korrupsionit. Bazuar në nenin 4, pika 4 dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 18.1.2019, është vendosur kryesues z. Roland Ilia dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit, dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e tij.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 19.3.2020, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda, bazuar në të tri kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda, në seancë dëgjimore, në datën 10.6.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.6.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.
9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ajo paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe në përfundim të seancës dëgjimore kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore e, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Etleva Deda në seancën e datës 12.6.2020, në të cilën subjekti ishte prezent.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”.
- b) Raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
- c) Informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese.
- ç) Raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues.
- d) Dokumente shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.
- dh) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik.
- e) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht.
- ë) Denoncimet nga publiku.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i deklaramit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.<sup>2</sup>

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarameve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklaram të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

<sup>1</sup>“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, ‘Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë’, ligjin ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’ si dhe ‘Kodin e Procedurave Administrative’.

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

17. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, në deklaratën e saj të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, si dhe nga Komisioni, rezulton se ka në pronësi një apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë.

19. **Apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>**, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Ky apartament është blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.12.2011, në vlerën 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro.

20. Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për blerjen e kësaj pasurie:

- i. Kredi nga “Raiffeisen Bank” në shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë në vitin 2006, sipas Kontratës së Kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006.
- ii. Të ardhura nga paga të siguruara nga puna, ndër vite.
- iii. Dhuratë nga prindërit në shumën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro (ose 2.057.550 lekë) në vitin 2009, sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2011.
- iv. Të ardhura në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga shitja e njësisë së shërbimit me sip. 26,12 m<sup>2</sup>, Durrës, në vitin 2007 (deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007), së bashku me prindërit dhe motrën L.D., shtetasit F.C., (në vlerën 1.000.000 lekë – pjesa takuese 250.000 lekë), me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.12.2007.
- v. Të ardhura në vlerën 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro nga shitja e njësisë së shërbimit me sip. 47,7 m<sup>2</sup>, Durrës, në vitin 2013 së bashku me prindërit dhe motrën L.D., shtetasve A., dhe E.C., në vlerën totale 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro me Kontratën me Rezervë me afat nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.7.2013. Burimi: apartamenti i privatizuar në vitin 1994, kthyer në dyqan.
- vi. Dhuratë nga babai, B.D., të vlerës 4.000 (katër mijë) euro në vitin 2011 (deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011), sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011.
- vii. Hua në vlerën 8.000 (tetë mijë) euro (ose 1.106.400 lekë) në vitin 2011, deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, nga shtetasja H.D., (vjehera e xhaxhait B.D.) sipas Kontratës së Huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011.

21. ZVRPP-ja Tiranë<sup>3</sup> informon se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar pasuria apartament me sip. 107.5 m<sup>2</sup> në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Sipas kartelës së pasurisë, apartamenti është bllokuar në favor të “Raiffeisen Bank” sipas Kontratës së Hipotekimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.11.2013, për kredinë e marrë në vitin 2006.

22. Me Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.10.2009, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti porosit apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup> në katin e pestë banim, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro (800 euro/m<sup>2</sup>), e cila do të paguhet me dy këste: (1) 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale; (2) 20.000 (njëzet mijë) euro do të likuidohet me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës, pasi të jetë përfunduar ndërtimi i godinës.

23. Në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011, administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaron se ka marrë nga subjekti shumën totale prej 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro, jashtë zyrës noteriale për blerjen e apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, sipas Kontratës së Porosisë datë 9.10.2009. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. shpjegon, ndër të tjera, se në datën 9.10.2009 kur

<sup>3</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019.

është lidhur kontrata e porosisë, subjekti ka likuiduar këstin e parë prej 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, ndërsa këstin e dytë prej 20.000 (njëzet mijë) euro e ka likuiduar në datën 17.11.2011<sup>4</sup>.

24. UKT-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka një kontratë me vendndodhje në rrugën “\*\*\*”, Tiranë. Me kërkesë të znj. Etleva Deda, datë 13.9.2012, emri në kontratë është ndërruar nga z. A.C., në emrin e subjektit të rivlerësimit.

25. OSHEE-ja<sup>5</sup> informon se në emër të subjektit të rivlerësimit gjendet një kontratë me adresë: rruga “\*\*\*”, Tiranë. Me kërkesë të znj. Etleva Deda, në datën 7.2.2018 është bërë ndryshim emri.

26. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë se përse kontrata për furnizim me ujë dhe drita të kësaj pasurie janë regjistruar fillimisht në emrin e shtetasit A.C.

**27. Analiza e burimeve të krijimit të pasurisë apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, në adresën rruga “\*\*\*”, Tiranë.**

28. Shuma 5.000.000 (pesë milionë) lekë, përfituar nga kredia në “Raiffeisen Bank” në vitin 2006, sipas Kontratës së Kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006 është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit.

29. Subjekti deklaron në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, përfituar kredi me kushte lehtësuese në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, përfituar me kontratën e kredisë bankare për blerje apartamenti në datën 18.9.2006, lidhur me “Raiffeisen Bank”. Subjekti deklaron shlyerjen e kësaj kredie dhe vlerën e mbetur të detyrimit në deklaratat periodike vjetore të mëpasshme dhe në deklaratën “Vetting”.

30. Nga dokumentacioni bankar i administruar rezulton se subjekti ka përfituar kredi në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, me Kontratën e Kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006, me objekt blerje apartamenti ose rikonstruksion, me normë interesi 3 % dhe kohëzgjatje 168 muaj (14 vjet). Kolateral për këtë kredi është vendosur apartamenti me sip. 144 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në \*\*\*, Plazh, Durrës, në pronësi të bashkëshortëve F., dhe A.G<sup>6</sup>.

31. Kontrata e Kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006, mbështetet në marrëveshjen nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2005, lidhur ndërmjet “Raiffeisen Bank” dhe Ministrisë së Financave, për trajtimin me strehë të funksionarëve të lartë të shtetit, lidhur në zbatim të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999 dhe VKM-së nr. 830, datë 10.12.2004.

32. Nga dokumentacioni bankar<sup>7</sup> rezulton se subjekti ka depozituar në bankë për marrjen e kredisë një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., lidhur në datën 25.8.2006 me objekt “blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 132, 5 m<sup>2</sup>”, në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, k. \*\*\*, Durrës, me çmim 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë.

33. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me pasurinë apartament me sip. 132, 5 m<sup>2</sup>, në lagjen nr. \*\*\*, Durrës, burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe shpjegime se përse kjo pasuri nuk ishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 dhe as në deklaratën “Vetting”.

34. Në shpjegimet e saj, subjekti ndër të tjera, përgjigjet se<sup>8</sup> në datën 25.8.2006, ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me sip. 132,5 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, në lagjen nr. \*\*\*, Durrës, me çmim 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë. Duke

<sup>4</sup> Shoqëria i bashkëlidh përgjigjes kontratën e porosisë; Deklaratën Noteriale nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, datë 9.10.2009; kontratën e shitblerjes; vërtetimin e shoqërisë, data 3.9.2018.

<sup>5</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019.

<sup>6</sup> Tezja e subjektit me bashkëshortin e saj.

<sup>7</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>8</sup> Shihni pyetësozin nr. 2, datë 20.11.2019.

vlerësuar që për mbarëvajtjen e punës dhe të jetesës do të ishte më mirë blerja e një apartamenti banimi në Tiranë dhe jo në Durrës (për efekt distance nga qendra e punës në banesë), disa ditë pas përpilimit të kontratës së porosisë, subjekti shprehet se ka hequr dorë nga blerja e apartamentit, duke i dhënë të drejtën shtetasit F.F., t'ia shesë kujtdo shtetasi tjetër. Me shtetasin F.F., i cili është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti shprehet se ka marrëdhënie të posaçme, pasi është djali i tezes së babait të saj, shtetasit B.D., ndaj edhe anulimin (revokimin) e kontratës së sipërmarrjes e kanë bërë me veprime konkludente.

Subjekti deklaron se apartamentin, të cilin kishte porositur, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ia ka shitur më vonë shtetas L.D., duke paraqitur, ndër të tjera, Kontratë Shitje apartamenti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.9.2012, ku shtetasja L.D., i ka blerë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., apartament banimi me sip. 122 m<sup>2</sup>, në katin \*\*\*.

35. Subjekti shprehet se në kushtet kur hoqi dorë nga blerja e apartamentit, pak ditë pasi kishte lidhur kontratën e sipërmarrjes, duke vlerësuar se në datën 31.12.2006, nuk kishte ndryshime të interesave private (pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme), nuk e ka deklaruar në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2006. Gjithashtu, subjekti shpjegon se duke qenë se nuk është krijuar pasuri nuk e ka shënuar në deklaratën “Vetting”, por ka deklaruar rregullisht kredinë dhe detyrimin e saj.

36. Komisioni i kërkoi informacion shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., mbi statusin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur në datën 25.8.2006, me objekt “blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 132, 5 m<sup>2</sup>”, në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, k. \*\*\*, Durrës, me znj. Etleva Deda, mënyrën se si janë kryer pagesat për këtë apartament, si dhe dokumentacionin mbështetës (mandatpagesa/ arkë/bankë) mbi pagesat e kryera nga shtetasja Etleva Deda.

37. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2019, përfaqësuesi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. F.F., informon Komisionin se në datën 25.8.2006 kjo shoqëri ka lidhur përpara noterit kontratën e sipërmarrjes me subjektin Etleva Deda për blerjen e apartamentit me sip. 132,5 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë. Në kontratën e sipërmarrjes është shënuar se prej porositëses është likuiduar kësti i parë i pagesës në vlerën prej 1.000.000 (një milion) lekësh. Z. F.F., deklaron me përgjegjësi të plotë ligjore se subjekti nuk e ka paguar këtë këst dhe se vetëm pak ditë pas përpilimit të kontratës ajo ka hequr dorë nga blerja e apartamentit, duke i dhënë të drejtën shoqërisë që t'ia shesë dikujt tjetër.

38. Përfaqësuesi i shoqërisë deklaron se nisur nga fakti që babanë e subjektit, z. B.D., e ka djalin e tezes, anulimi i kontratës nuk është bërë përpara noterit, por në kushte mirëbesimi. Sipas deklarimeve të z. F.F., ky apartament i është shitur shtetas L.D. Për të provuar këtë fakt, përfaqësuesi i shoqërisë vendosi në dispozicion të Komisionit, ndër të tjera, Kontratën e Shitjes së apartamentit shtetas L.D., me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.9.2012.

39. Komisioni pyeti subjektin nëse e kishte njoftuar bankën lidhur me revokimin e kontratës për blerjen e apartamentit dhe destinacionin e kredisë, si dhe përse nuk ka deklaruar, ndër vite, shumën *cash* të mbajtur në banesë.

40. Subjekti shprehet se në vitin 2006, ka hequr dorë nga blerja e apartamentit në qytetin e Durrësit, sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.2006, por jo nga qëllimi për të cilin kishte marrë kredinë, blerjen e një apartamenti. Znj. E.D., shpjegon, në vijim, se ka njoftuar bankën kredituese kur ka blerë apartamentin e ri, duke kërkuar zëvendësimin/ndryshimin e kolateralit dhe duke vendosur apartamentin në Tiranë si garanci me Kontratë Hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.11.2013, lidhur me “Raiffeisen Bank”.

41. Duke e deklaruar kredinë bankare në deklaratat e interesave private periodike/vjetore, nga viti 2006 dhe deri më sot, në zërin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, pavarësisht

se shumën e kredisë e ka pasur gjendje *cash* në banesë, subjekti shprehet se e ka vlerësuar si fakt të deklaruar. Kjo edhe për faktin se nuk është kryer asnjë veprim juridik gjatë asaj periudhe duke mos e vlerësuar se e njëjta shumë duhej deklaruar edhe në një zë tjetër, si gjendje *cash*.

**42. Të ardhura të siguruara nga paga, ndër vite,** të përdorura për pagesën e kryer të këstit të parë prej 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, paguar në datën 9.10.2009. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore ka rezultuar se totali i kursimeve *cash* të deklaruara me burim nga pagat e subjektit, rezulton në vlerën 2.050.000 (dy milionë e pesëdhjetë mijë) lekë, duke përfshirë edhe kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, me përshkrimin “400.000 lekë kursime nga paga për periudhën si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nga janari deri në dhjetor të vitit 2009.”

43. Në pyetësorin e datës 20.11.2019, subjekti ka deklaruar se kursimet nga paga të siguruara deri në vitin 2009 (duke përfshirë kursimet e atij viti) i ka zeruar në vitin 2009 dhe se kursimet e vitit 2009, pavarësisht se nuk i ka pasur gjendje në datën 31 dhjetor (pasi i ka përdorur për pagesën e këstit) i ka deklaruar sepse me ato kursime ka likuiduar pjesërisht këstin e blerjes së apartamentit.

**44. Në lidhje me kursimet e përdorura për pagesën e kryer të këstit të dytë prej 20.000 (njëzet mijë) euro, të paguar në datën 17.11.2011,** totali i kursimeve *cash* të deklaruara me burim nga pagat e subjektit, rezulton në vlerën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë. Edhe në këtë rast, subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 se: “... vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë kursime nga paga për periudhën si gjyqtare (pjesërisht edhe si kryetare) pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nga janari deri në dhjetor 2011”.

45. Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI, me deklaratën e datës 22.1.2015, se: “... shuma prej 700.00 (shtatëqind mijë) lekësh e deklaruar nga ana ime në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 është gjendje deri në datën 31.12.2011, pra, nuk është krijuar brenda atij viti, por është mbartur nga vitet e mëparshme”.

46. Në pyetësorin e datës 20.11.2019, subjekti ka deklaruar në Komision se kursimet e krijuara në vitet 2010 dhe 2011 i ka zeruar në datën 17.11.2011, kur ka paguar këstin e dytë të blerjes së apartamentit. Kursimet e vitit 2011, pavarësisht se nuk i ka pasur gjendje në datën 31 dhjetor (pasi i ka përdorur për pagesën e këstit të dytë), i ka deklaruar sepse me ato kursime ka likuiduar pjesërisht këstin e blerjes së apartamentit.

**47. Dhuratë nga prindërit në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro (ose 2.057.550 lekë) në vitin 2009.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti deklaroi dhuratë në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro nga prindërit pa akt noterial, për shkak të marrëdhënies së posaçme. Subjekti ka paraqitur Deklaratën Noteriale<sup>9</sup> nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2011, të prindërve të subjektit, në të cilën shtetasit B., dhe I.D., deklarojnë se i kanë dhuruar subjektit vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro (ose 2.074.500 lekë<sup>10</sup>) në tetor të vitit 2009 me qëllim blerjen e apartamentit në Tiranë.

48. Kjo shumë e ka burimin te diferenca midis shitjes së apartamentit 3+1, ndërtuar nga firma “\*\*\*” sh.p.k., kundrejt shtetasit Xh.B., në datën 4.12.2006, në shumën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë dhe blerjes së apartamentit 2+1, ndërtuar nga firma “\*\*\*” sh.p.k.,<sup>11</sup> në datën 15.12.2006, në vlerën 5.300.000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë (kjo diferencë rezulton të jetë në vlerën prej 3.700.000 lekësh). Ata deklarojnë se këto dy apartamente janë të paregjistruara, deri në datën e lëshimit të deklaratës, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Kjo deklaratë është kryer me qëllim konfirmimin e dhurimit në vitin 2009, si dhe burimin e shumës së dhuruar.

<sup>9</sup> Dosja e ILDKPKI-së, dokument nr. 4/2.

<sup>10</sup> Sipas kursi të Bankës së Shqipërisë.

<sup>11</sup> Administrator, z. Q.K.

49. Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se ky apartament ende nuk është i regjistruar në ZVRPP-në Durrës (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës, Durrës), nga shoqëria e ndërtimit. Subjekti shpjegon se pallati ku ndodhet apartamenti me sip. 110 m<sup>2</sup>, i cili zotërohet nga babai i subjektit, z. B.D., është në krah të pallatit në të cilin ndodhej apartamenti që babai i saj i ka shitur shtetasit Xh.B., ndaj kanë të njëjtën adresë: Rr. “\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, Durrës. Me përditësimin e adresave nga pushteti lokal, rruga “\*\*\*\*” u emërtua rruga “\*\*\*”.

50. Subjekti ka paraqitur<sup>12</sup> në Komision dokumentacionin, si vijon:

- a) Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.,<sup>13</sup> me anë të së cilës z. B.D., blen apartamentin 3+1, me sip. 130 m<sup>2</sup>, në vlerën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD (ose 5.217.120 lekë), nga të cilat kësti i parë prej 24.000 (njëzet e katër mijë) USD është paguar ditën e lidhjes së kontratës në praninë e noterit, ndërsa kësti i dytë prej 24.000 USD do të paguhet gjatë periudhës 2-vjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë.
- b) Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.12.2006, me të cilën z. B.D., i shet z. Xh.B., apartamentin me sip.130 m<sup>2</sup>, në vlerën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë (likuiduar jashtë zyrës noteriale). Ky apartament nuk është regjistruar në ZVRPP-në Durrës, pasi nuk është realizuar regjistrimi fillestar nga shoqëria ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>14</sup>
- c) Kontratën e Shitjes me Kusht, datë 15.12.2006, të panoteruar dhe Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2016,<sup>15</sup> sipas të cilave z. B.D., ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. Q.K., apartamentin 2+1, Rr. “\*\*\*\*” me sip. 110 m<sup>2</sup>, në vlerën 5.300.000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë, të paguar në datën 15.12.2006 (bashkëngjit mandatpagesën nr.7, datë 15.12.2006). Sipas deklaratës noteriale kontrata për kalimin e pronësisë së apartamentit në favor të z. B.D., do të realizohet me regjistrimin e objektit në ZVRPP-në Durrës.

51. Nga dokumentacioni bankar i administruar<sup>16</sup> rezulton se z. B.D., ka përfutuar në llogarinë e tij bankare në “ProCredit Bank” vlerën prej 7.000.000 (shtatë milionë) lekësh në datën 27.11.2006, me përshkrimin “transfertë personale M.A., ose M.N., – likuidim blerje apartamenti”. Këtë shumë z. B.D., e ka kaluar në depozitë dhe e ka tërhequr *cash* pjesë-pjesë, së bashku me interesat bankare deri në datën 31.12.2007. Gjithashtu, në të njëjtën llogari, z. B.D., ka derdhur *cash* vlerën prej 3.600.000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekësh në datën 2.5.2007, të cilën e ka tërhequr *cash* së bashku me interesat bankare, në datën 2.8.2007.

52. Duke qenë se kjo shumë ka shërbyer për dhënien dhuratë nga prindërit të vlerës prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, subjekti u pyet se cila ishte lidhja mes blerësit të apartamentit me sip.130 m<sup>2</sup>, z. Xh.B., dhe shtetasve M.A., ose M.N., të cilët kanë kryer transfertën e parave. Subjekti ka shpjeguar se ata ishin vajza dhe dhëndri i z. Xh.B., duke paraqitur një certifikatë të gjendjes familjare të tyre dhe se kanë kryer këtë veprim për llogari të tij.

**53. Lidhur me burimin për blerjen e apartamentit në vlerën 48.000 (dyzet e tetë mijë) euro, në datën 20.8.2003**, i cili pas rishitjes në vitin 2006, ka shërbyer si burim për dhurimin e vlerës prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni rezulton se të ardhurat në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj deri në vitin 2003 kanë qenë të ardhurat e subjektit nga pagat nga puna si zv/gjyqtare dhe gjyqtare, si dhe nga aktiviteti tregtar i prindërve (nënës I.D., për periudhën 1994 – 2002 dhe babait B.D., për periudhën 2002 – 2003).

<sup>12</sup> Pyetësori nr. 2, datë 20.11.2019.

<sup>13</sup> Ortakët e kësaj shoqërie janë shtetasit F.F., dhe Q.K.

<sup>14</sup> Në kontratën e datës 20.8.2003 shitëse është shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me ortakë z. F.F., dhe z. Q.K., ndërsa në kontratën e datës 4.12.2006 emërtimi i shoqërisë ndërtuese të cituar është “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator z. F.F.

<sup>15</sup> Deklarata noteriale e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Q.K., dhe e babait të subjektit të rivlerësimit.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot, datë 11.3.2019, nga “ProCredit Bank” sh.a.



54. Nëna e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhura nga aktiviteti tregtar biznes i vogël “tregti artikuj të ndryshëm industrialë”, me kod fiskal \*\*\*, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, lagjja nr. \*\*\*, Durrës, për periudhën 1994 – 2002, sipas vërtetimit të marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, pasqyrohen vetëm të ardhurat *bruto*, dhe jo ato *neto*.

55. Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI<sup>17</sup> vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, i cili jep informacion mbi aktivitetin tregtar të tatimpaguesit I.(I.) D., me kod fiskal \*\*\* (s’ka NIPT). Nga dokumentacioni i administruar në dosjen fizike, tatimpaguesi është hapur me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 4.11.1993, dhe sipas deklaratës për çelje veprimtarie firmosur nga tatimpaguesi, data e krijimit në tatime është më 1.4.1994. Ky subjekt është mbyllur me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 17.6.2002 dhe nuk jep informacion në lidhje me pagesën e tatimit mbi këtë qarkullim.

56. Sipas legjislacionit tatimor në fuqi<sup>18</sup> në vitin 2002, subjektet tregtare mund të çregjistroheshin vetëm nëse kishin paguar detyrimet për tatimet dhe taksat. Në rast kundërshtimi nga organi tatimor, gjykata nuk i kryente veprimet për çregjistrimin.

57. I njëjti institucion ka informuar ILDKPKI-në<sup>19</sup> në vitin 2017 se shtetasja I.M.D., nuk figuron e regjistruar për ushtrim aktiviteti në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Gjithashtu, edhe në përgjigjen e dërguar Komisionit, nuk jepen të dhëna për këtë subjekt tregtar.

58. Nisur nga mospërputhjet, ILDKPKI-ja ka kërkuar sqarime në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, dhe ky institucion ka sqaruar se përgjigjja negative mbi qarkullimin ka ardhur nga fakti se ky subjekt tregtar nuk është regjistruar në sistemin informatikë C@ts me NIPT, pasi ka qenë i regjistruar me kod fiskal. Të dhënat e pasqyruara në vërtetimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë nxjerrë nga dosja fizike në arkivën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, sipas dokumenteve të dorëzuara nga vetë tatimpaguesi.

59. Bashkia Durrës informon<sup>20</sup> se subjekti I.D., nuk rezulton i regjistruar në sistemin informatik të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

60. Babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhura nga aktiviteti tregtar, biznes i vogël “tregti artikuj të ndryshëm industrialë”, për periudhën 2002 – 2008, sipas vërtetimeve të marra nga institucionet, ku pasqyrohen vetëm të ardhurat *bruto*, dhe jo ato *neto*.

61. QKB-ja<sup>21</sup> informon se shtetasi B.D., figuron i regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\*, në datën 20.1.2003, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës. Ky subjekt është çregjistruar në datën 28.5.2010.

62. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës<sup>22</sup> informon se shtetasi B.D., figuron i regjistruar si tatimpagues me NIPT \*\*\*, me objekt veprimtarie “tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, pa mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije dhe duhan”, ç’regjistruar në datën 28.5.2010. Ky institucion vendos në dispozicion qarkullimin e realizuar nga ky tatimpagues dhe konfirmon se nuk ka detyrime tatimore të pashlyera.

63. Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI<sup>23</sup> vërtetimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, i cili jep informacion mbi aktivitetin tregtar të tatimpaguesit B.D., me NIPT \*\*\* qarkullimin e kryer nga ky subjekt.

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2016, nga DRT-ja Durrës, dosja ILDKPKI, dok. 4/8.

<sup>18</sup>Neni 32 i ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, dokumenti 34.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, nga Bashkia Durrës, dosja e ILDKPKI-së, dokumenti 35.

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019, nga QKB-ja.

<sup>22</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2019, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

<sup>23</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2016, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, dosja e ILDKPKI-së, dokumenti 4/7.

64. Bashkia Durrës<sup>24</sup> informon se subjekti B.D., rezulton i regjistruar me NIPT \*\*\* dhe ka kryer mbyllje në QKB në datën 18.1.2010.

65. Në mënyrë të përmbledhur, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve, si dhe nga paga e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1994 – 2003, paraqitet në tabelën vijuese:

VITI	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	TOTAL
Qarkullimi I.D., Kod Fiskal ***	200 650	254 580	315 580	334 390	348 310	1 275 400	1 422 900	1 486 000	525 000	0	6 162 810
Qarkullimi B.D., NIPT ***	0	0	0	0	0	0	0	0	568 000	1 100 000	1 668 000
<b>Total qarkullimi</b>	<b>200 650</b>	<b>254 580</b>	<b>315 580</b>	<b>334 390</b>	<b>348 310</b>	<b>1 275 400</b>	<b>1 422 900</b>	<b>1 486 000</b>	<b>1 093 000</b>	<b>1 100 000</b>	<b>7 830 810</b>
Të ardhura nga paga E. Deda	132 093	141 165	165 216	167 760	236 093	261 556	396 651	452 830	492 844	607 643	3 053 851

**66. Të ardhura në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga shitja e njësisë së shërbimit në vitin 2007.** ZVRPP-ja Durrës<sup>25</sup> konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit, të prindërve B., dhe I.D., si dhe motrës A.D., ka qenë e regjistruar pasuria apartament me sip. 77.35 m<sup>2</sup> në katin e tretë, në rrugën “\*\*\*”, Durrës, e fituar nga privatizimi në vitin 1994 kundrejt vlerës 20.439 (njëzet mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

67. Me Kontratën e Shkëmbimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.3.2004, këtë apartament e shkëmbejnë me apartamentin me sip. 73.85 m<sup>2</sup>, në katin 1 të të njëjtit pallat, i cili ishte në pronësi të shtetasve Sh., L., dhe O.D.

68. Me vendimin nr. \*\*\*, të datës 28.4.2006 të Këshillit të Rregullim Territorit të Bashkisë Durrës, për ndryshim destinacioni, kjo pasuri është kthyer nga apartament banimi në ambiente shërbimi me sip. 47.7 m<sup>2</sup> dhe 26.15 m<sup>2</sup>. Sipas aktit të kolaudimit, vlera e preventivuar për adoptimin e këtij objekti ka dalë 229.536 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, ndërsa vlera faktike e punimeve është 200.100 (dyqind mijë e njëqind) lekë. Punimet janë kryer në periudhën maj - tetor 2006, nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

69. Në datën 24.12.2007, subjekti dhe familjarët i shesin pasurinë dyqan me sip. 26.15 m<sup>2</sup> në rrugën “\*\*\*”, k. \*\*\*, p. \*\*\*, Durrës, shtetasit F.Ç., sipas Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.12.2007, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

70. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 shitjen e pasurisë së sipërcituar, në pjesën takuese 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë me përshkrimin: “zotëroj ¼ e çmimit të shitjes, konkretisht 250.000 lekë”.

71. Në pyetësorin e datës 20.11.2019<sup>26</sup>, subjekti deklaron se shumën e përfituar nga shitja e dyqanit, e ka mbajtur cash deri në vitin 2009 dhe e ka përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit në këtë vit.

**72. Dhuratë nga babai në vlerën 4.000 (katër mijë) euro (ose 553. 200 lekë<sup>27</sup>) në vitin 2011.** Subjekti ka paraqitur Deklaratën Noteriale<sup>28</sup> nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011, në të cilën babai i subjektit, z. B.D., deklaron se i ka dhuruar vajzës së tij vlerën 4.000 (katër mijë) euro me qëllim blerjen e një apartamenti në Tiranë. Në të njëjtën datë, subjekti sipas kontratës noteriale me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., ka shlyer shumën e mbetur prej 20.000 (njëzet mijë) euro për blerjen apartamentit në Tiranë.

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, nga Bashkia Durrës, dosja e ILDKPKI-së dokumenti 35.

<sup>25</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2019.

<sup>26</sup>Përgjigja nr. 1.

<sup>27</sup>Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë.

<sup>28</sup>Dosja e ILDKPKI-së, dokument nr. 4/2.

73. Në procesverbalin e datës 27.11.2012, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti deklaroi se si burim për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e të atit nga puna e tyre në vite nga aktiviteti privat “dyqan”, si dhe nga shitja e apartamenteve.

74. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës informon se babai i subjektit të rivlerësimit, z. B.D., ka ushtruar aktivitet tregtar për periudhën 2004 – 2008 dhe vendos në dispozicion qarkullimin e këtij subjekti (përveç vitit 2007). Ky institucion konfirmon se subjekti B.D., nuk ka detyrime tatimore të pashlyera.

75. Subjekti ka paraqitur në ILDKPKI<sup>29</sup> vërtetim, sipas të cilit subjekti B.D., me NIPT \*\*\*, me objekt veprimtarie “tregti artikuj industriale”, për vitin 2007 është klasifikuar si subjekt me xhiro në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë.

76. Në mënyrë të përmbledhur, qarkullimi i realizuar nga subjekti B.D., paraqitet në tabelën e mëposhtme:

VITI	2004	2005	2006	2007	2008	TOTAL
Qarkullimi B.D., NIPT ***	1 500 000	2 000 952	2 000 000	2 000 000	1 705 000	205 952

77. Me një përlllogaritje të thjeshtë, pa bërë analizë ekonomike mbi të ardhura/shpenzime dhe marzhin e fitimit, referuar vlerës prej 4.000 euro të dhuruar, vërehet se babi i subjektit ka pasur mundësi financiare për dhurimin e kësaj shume.

**78. Hua në vlerën 8.000 (tetë mijë) euro (ose 1.106.400 lekë) në vitin 2011.** Si burim për krijimin e shumës së dhënë hua në vitin 2011, nga shtetasja H.D., (vjehera e xhaxhait B.D.) ka shërbyer shitja e apartamentit me sip. 64,84 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, Durrës, kundrejt shtetasit O. S., me Kontratën e Shitblerjes së apartamentit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.4.2010, në vlerën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë. Me Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.8.2013, znj. H.D., deklaroi se subjekti e ka shlyer huan jashtë zyrës noteriale.

79. Gjatë hetimit administrativ të kryer, subjekti deklaroi, ndër të tjera, se<sup>30</sup> me marrjen e vlerës prej 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, nga shitja e njësisë së shërbimit në vitin 2013, me sip. 47.7 m<sup>2</sup> në Durrës së bashku me prindërit dhe motrën L.D., në datën 28.8.2013, ka shlyer huan prej 8.000 (tetë mijë) euro, të marrë nga shtetasja H.D., në vitin 2011. Analiza financiare përfshin huan në vlerën 8.000 (tetë mijë) euro në vitin 2011, si dhe shlyerjen e saj në vitin 2013. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 subjekti deklaroi likuidimin e huas znj. H.D., pa deklaruar burimin dhe gjithashtu as gjendjen *cash* në banesë.

**80. Të ardhura në vlerën 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro nga shitja e njësi shërbimi në vitin 2013.** Subjekti ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2013, ku shitësit B., I., E., dhe A.D., deklarojnë se i kanë shitur shtetasve A., dhe E.C., pasurinë e mësipërme në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, e cila është likuiduar totalisht nga blerësit.

81. BKT-ja informon<sup>31</sup> se shtetasi B.D., ka pasur një llogari rrjedhëse me nr. \*\*\* pranë kësaj banke, ku në datën 13.8.2013 është transferuar vlera 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro me përshkrimin “transfertë A. M. C., – për B.D., likuidim blerje dyqani”. Në datën 14.8.2013, z. B.D., ka tërhequr *cash* vlerën 34.985 (tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) euro.

82. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 shitjen e pasurisë së sipërcituar, në shumën totale 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro së bashku me bashkëpronarët B., I., dhe A.D., duke deklaruar se zotëron 1/4. Në pyetësorin e datës 20.11.2019<sup>32</sup>, subjekti

<sup>29</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2016, nga Bashkia Durrës, dosja e ILDKPKI-së dok. 4/7.

<sup>30</sup> Shihni pyetësorin nr. 2, datë 20.11.2019.

<sup>31</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019, nga BKT-ja.

<sup>32</sup>Përgjigja nr.1.

deklararon se shumën e përfituar nga shitja e dyqanit (pjesën takuese), e ka përdorur për të shlyer huan në vlerën prej 8.000 (tetë mijë) euro të marrë nga shtetasja H.D., në vitin 2011 (trajtuar më lartë), ndërsa pjesën e mbetur prej 5.750 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro e ka shpenzuar në vitin 2014 për shpenzime mjekësore dhe mobilimi.

83. Në përfundim të hetimit administrativ për pasurinë apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, në Tiranë, porositur në vitin 2009 dhe blerë me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.12.2011, në vlerën 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro, Komisioni konstaton se:

- a) Kontrata e sipërmarrjes lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 25.8.2006, duket si një veprim fiktiv i krijuar për përfitimin e kredisë.
- b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar (DPV) lidhur me destinacionin e shumës 5.000.000 lekë të tërhequr në vitin 2007 dhe as gjendjen *cash* në banesë, përkatësisht, në vitet 2007 dhe 2008, duke mbetur kështu i paqartë burimi i të ardhurave në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, përdorur në vitin 2009 për blerjen e apartamentit.
- c) Subjekti ka deklaruar se ka përdorur në vitin 2009 shuma të kursimeve të saj *cash* nga paga, si burim për blerjen e apartamentit, ndërkohë që i ka deklaruar ato edhe si gjendje *cash* në fund të vitit 2009.
- ç) Subjekti ka deklaruar se ka përdorur në vitin 2009 të ardhurat nga shitja e pasurisë dyqan me sip. 26,15 m<sup>2</sup> në Durrës, në vitin 2007, por nuk ka deklaruar në fund të vitit pakësimin e gjendjes *cash* në banesë. Po ashtu, nuk ka provuar lidhur me pagimin e tatimit mbi fitimin nga shitja e pasurisë dyqan me sip. 26,15 m<sup>2</sup>, në vitin 2007, në Durrës.
- d) Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se ka shlyer në vitin 2013, huan e marrë në vitin 2011, me të ardhurat nga shitja e pasurisë, pa deklaruar burimin dhe gjithashtu as gjendjen *cash* në banesë në atë vit.
- dh) Subjekti duhet të shpjegojë bindshëm mundësinë financiare të prindërve të saj për blerjen e pasurisë apartament në vlerën 48.000 (dyzet e tetë mijë) euro në datën 20.8.2003, i cili pas shitjes në vitin 2006, ka shërbyer si burim për dhurimin e vlerës 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, si dhe pagimin e tatimit mbi fitimin nga shitja e apartamentit në vitin 2006, në vlerën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë.

84. Në përfundim të hetimit administrativ, në bazë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar lidhur me burimin e ligjshëm të shumave të përdorura për blerjen e apartamentit, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

**85. Znj. Etleva Deda ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit, sa më poshtë vijon:**  
“Sikurse ka rezultuar edhe nga hetimi administrativ kryer prej jush, e vetmja pasuri e paluajtshme është një apartament banimi, me adresë: Rr. ‘\*\*\*\*’, nd.\*\*\*, h.\*\*\*, ap.\*\*\*, Njësia Bashkiake Nr.\*\*\*, Tiranë.

*Sipas Kontratës së Porosisë, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.10.2009, kam porositur te shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., apartament banimi, me sip. 115 m<sup>2</sup>, në katin e pestë banim, në seksionin A, në pozicion jug-perëndim, në rrugën ‘\*\*\*\*’, Tiranë. Shuma e përgjithshme e apartamentit është 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro.*

*Sikurse pasqyrohet edhe në këtë kontratë porosie (fleta e dytë), unë në po të njëjtën datë, kam likuiduar këstin e parë prej 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, duke mos pasur asnjë pretendim nga sipërmarrësi.*

*Në datën 17.11.2011, kam likuiduar këstin e dytë prej 20.000 (njëzet mijë) euro, duke likuiduar vlerën totale të blerjes së apartamentit. Në momentin e likuidimit të të gjithë shumës prej 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro, përpara noteres V. S., kemi hartuar, unë Etleva Deda dhe administratori i shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., z. A. M., Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ku A. M., me cilësinë e administratorit deklaroi (citoj): ‘...deklaroj se kam marrë nga e quajtura*

*Etleva Deda të gjithë shumën totale prej 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro, jashtë kësaj zyre, që rrjedh sipas kontratës së mësipërme dhe pala Etleva Deda nuk ka asnjë detyrim për blerjen e kësaj prone...’.*

*Në datën 9.12.2011, kemi përpiluar Kontratë Shitblerjeje prone pasurie të paluajtshme apartament banimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ku edhe në të pasqyrohet se (citoj): ‘...shitësi deklaroi se e ka marrë tërësisht shumën nga blerësi, ndërsa blerësi deklaroi se mori pronën në dorëzim në gjendje të lirë’.*

*Ujësjetllës Kanalizime Tiranë ju ka konfirmuar se unë, Etleva Deda, kam një kontratë, me adresë: Rr. ‘\*\*\*’, Tiranë, dhe se me kërkesën time, në datën 13.9.2012, emri në kontratë është ndërruar nga A. C., në emrin tim.*

*Lidhur me pyetjen tuaj, shpjegoj se:*

a) *Sipas Kontratës së Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 29.9.2005, të përpiluar përpara noteres V.S., të lidhur ndërmjet shtetasit A. C., me cilësinë e porositësit dhe shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., me cilësinë e sipërmarrësit, shtetasi A. C., ka porositur ndërtimin e një apartamenti banimi, në katin \*\*\*, me sip. 115 m<sup>2</sup> (duke përfshirë në këtë sipërfaqe edhe sipërfaqen e ambienteve të përbashkëta, Seksioni A, në pozicion jug-perëndim, në rrugën ‘\*\*\*’, Tiranë, me çmim 800 (tetëqind) euro/m<sup>2</sup>.*

*Po sipas kësaj kontrate, ky shtetas ka porositur edhe një garazh, me sipërfaqe 15-20 m<sup>2</sup>, me çmim 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.*

b) *Sipas Revokim Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2009, palët e sipërshënuara, shtetasi A.C., dhe shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k., kanë revokuar Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 29.9.2005, të lidhur ndërmjet tyre, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme, pa asnjë lloj kushti apo detyrimi karshi njeri-tjetrit, pra, shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k., mori në dorëzim apartamentin dhe garazhin.*

*Disa ditë më pas, në datën 9.10.2009, për të njëjtin apartament, kam lidhur Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.*

*Apartamenti, i cili tashmë është në pronësinë time, më parë është porositur nga shtetasi A. C., i cili është i panjohur prej meje dhe pas revokimit të kontratës së lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë së ndërtimit kam kryer veprimet juridike të sipërshënuara.*

*Në të tilla kushte, kontrata me UKT-në fillimisht ka qenë e regjistruar në emër të shtetasit A. C., dhe, më pas, në emrin tim.*

*Bashkëlidhur po ju dërgoj:*

- *Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., datë 29.9.2005, të përpiluar përpara noteres V. S., të lidhur ndërmjet shtetasit A.C., dhe shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.;*
- *Revokim Kontrate nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.10.2009, kryer ndërmjet shtetasit A. C., dhe shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.”.*

86. *Lidhur me burimet për blerjen e apartamentit, subjekti shpjegon se burimet janë ato të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore dhe në atë “Vetting” dhe se shuma prej 92.000 (nëntëdhjetë e dy mijë) euro është paguar me dy këste: (1) 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, likuiduar në datën 9.10.2009; (2) 20.000 (njëzet mijë) euro, likuiduar në datën 17.11.2011.*

87. *Subjekti ka shpjeguar, si vijon:*

87.1 *“Për këstin e parë prej 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, paguar prej meje në datën 9.10.2009, kanë shërbyer këto burime:*

a) *kredi bankare në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, përfutuar me Kontratë Kredie Bankare dhe Hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstruksion), me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006;*

b) *kursime nga pagat, ndër vite, deri në vitin 2009, në vlerën 2.050.000 (dy milionë e pesëdhjetë mijë) lekë;*

c) të ardhura nga shitja e dyqanit në datën 24.12.2007, në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) dhuratë nga prindërit e mi, shtetasit B.D., e I. D., në tetor të vitit 2009, në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

Vlera totale e burimeve që më kanë shërbyer për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit në pronësinë time është në vlerën 7.300.000 (shtatë milionë e treqind mijë) lekë plus 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

Në lidhje me diferencën negative të konstatuar, ju bëj me dije se edhe unë, sikurse shumica e popullsisë, këmbimin e lekut në euro, e kam kryer në momentet më të volitshme, duke ndjekur kursin e këmbimit. Si shumën e kredisë, edhe të ardhurat nga shitja e dyqanit në datën 24.12.2007, ashtu edhe kursimet nga paga ndër vite, i kam konvertuar nga lekë në euro në kohë të ndryshme, duke ndjekur kursin e këmbimit në favor të euros. Aktualisht nuk mund të përcaktoj se me sa i kam këmbyer (kjo pasi jo vetëm që është kohë e largët, por edhe se është veprim i kryer në shuma të ndryshme në kohë të ndryshme). Referuar konstatimit tuaj, ku është vërejtur një luhajtje e madhe e kursit të këmbimit në periudhën 2007 – 2009 (nga 121 në 137 sipas Bankës së Shqipërisë), nëse totali i burimeve në lekë, në vlerën 7.300.000 (shtatë milionë e treqind mijë), do të konvertohej me 121 lekë/euro, rezulton se totali i burimeve të konvertuara është në vlerën 60.330 (gjashtëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë) euro dhe duke i shtuar edhe vlerën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro (dhuratë e prindërve), totali i vlerës së burimeve për këstin e parë të pagesës së apartamentit shkon në 75.330 (shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë) euro, pra, 3.330 (tre mijë e treqind e tridhjetë) euro më shumë.

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se shuma e zotëruar prej meje nga burimet e deklaruara e të sipërshënuara, në datën 9.10.2009, ka qenë në vlerën 72.000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, nga të cilat 57.000 (pesëdhjetë e shtatë mijë) euro janë përfutur nga konvertimi i lekëve në euro. Burimet e deklaruara nga ana ime kanë qenë të mjaftueshme për pagesën e këtij kësti.

Për sa më sipër, diferenca në vlerën prej 518.690 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë e evidentuar prej jush si rezultat negativ, nuk ka ekzistuar.

87.2 Për këstin e dytë në vlerën prej 20.000 (njëzet mijë) euro, paguar prej meje në datën 17.11.2011, kanë shërbyer këto burime:

a) kursime të ardhura nga paga si gjyqtare në ish-Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda për vitet 2010 – 2011, në vlerën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, të deklaruara në deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2010 dhe 2011;

b) dhuratë nga prindërit në vlerën 4.000 (katër mijë) euro, deklaruar në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2011, sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011; si dhe

c) hua në vlerën 8.000 (tetë mijë) euro, marrë shtetasit H. D., (vjehrra e xhaxhait tim, shtetasit B. D.), pasqyruar në Kontratë Huaje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011, të përpiluar përpara noteres M. N.

Vlera totale e burimeve që më kanë shërbyer për pagimin e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në pronësinë time është 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë dhe 12.000 (dymbëdhjetë mijë) euro.

Në datën 18.9.2006, përpara noteres A. M., kam lidhur me 'Raiffeisen Bank' Kontratë Kredie Bankare dhe Hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstruksion), me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., sipas së cilës, 'Raiffeisen Bank' me cilësinë e kredidhënëses, më ka akorduar një kredi në shumën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, për blerjen e një apartamenti.

Kreditin e marrë e kam deklaruar si në deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2006 dhe në vazhdim, deri më sot, ashtu edhe në deklaratën 'Vetting'. Kjo kredi fillimisht më është dhënë për blerjen e një apartamenti në Durrës dhe konkretisht:

Në datën 25.8.2006, përpara noterit A. T., kam lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me shoqërinë e ndërtimit '\*\*\*' sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me sip. 132,5 m<sup>2</sup>, në adresë: Rr. '\*\*\*', lagjia nr. \*\*\*, Durrës, me çmim 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë.

Pavarësisht faktit se në kontratën e sipërshtuar, në f. 2 të saj, është shënuar që unë i kam likuiduar sipërmarrësit këstin e parë në vlerën prej 1.000.000 (një milion) lekësh, deklaroj me përgjegjësi të plotë, se nuk kam kryer pagimin e asnjë kësti.

Marrë shkas nga distanca e qendrës së punës me banesën, nga ngarkesa në punë dhe natyra e gjykimeve që kishite për kompetencë lëndore gjykata ku ushtrroja funksionin tim si gjyqtare, (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda), vlerësova se për mbarëvajtjen e punës dhe të jetesës sime do të ishte më mirë blerja e një apartamenti banimi në Tiranë dhe jo në Durrës, ndaj, disa ditë pas përpilimit të kontratës së sipërmarrjes kam hequr dorë nga blerja e apartamentit, duke i dhënë të drejtën shoqërisë së ndërtimit '\*\*\*' sh.p.k., t'ia shesë kujtdo shtetasi tjetër, me qëllimin për të blerë apartament në Tiranë.

Sikurse e kam sqaruar në përgjigjet e mia drejtuar jush, me shtetasin F. F., i cili është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë '\*\*\*' sh.p.k., kam marrëdhënie të posaçme, pasi është djali i tezes së babait tim, shtetasit B. D., ndaj edhe anulimin (revokimin) e kontratës së sipërmarrjes e kemi bërë me veprime konkludente.

Sqaroj se unë hoqa dorë nga blerja e apartamentit në Durrës, por jo nga qëllimi për të cilin më ishte lëvruar kredia bankare. Qëllimi për të cilin e kisha marrë kredinë (dhe isha në kërkim e në pritje të realizimit të tij), vazhdon të ishte blerja e një apartamenti.

Referuar rrethanave në të cilat ndodhesha, interesi im për të blerë apartament në Tiranë, ishte madje edhe më i lartë se përpara lëvrimit të kredisë.

Sqaroj se shtetasja L. D., e ka blerë apartamentin në vlerën 24.500 (njëzet e katër mijë e pesëqind) euro, pasi administratori i shoqërisë '\*\*\*' sh.p.k., shtetasi F. F., në datën 7.4.2005, i ka blerë nën kosto familjes së saj, tokë ullaiste, me sip. 3074 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, pasqyruar në Kontratën e Shitjes (tokë bujqësore) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.4.2005, përpiluar përpara noteres A. S. Njëra nga shitëset në kontratën e sipërshtuar është shtetasja N.D., nëna e bashkëshortit të shtetasës L.D, shtetasit M.D., fakt të cilin e provoj me Certifikatë Familjare me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 11.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës \*\*\*, Njësia Administrative Durrës \*\*\*.

Gjithashtu, në përgjigje të konstatimit tuaj, në datën 8.5.2020, kam kërkuar nga shtetasi F. F., një deklaratë noteriale, ku ndër të tjera, në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.5.2020, përpara noteres I. V. A., ka deklaruar (citoj):

'...me vullnet të lirë, i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast deklarimi të rremë, deklaroj se vlera e apartamentit prej 24.500 (njëzet e katër mijë e pesëqind) euro është caktuar me vullnet të plotë midis shitësit dhe blerësit, e cila është vlerë më e ulët sesa vlera e tregut, për shkak të konvertimit të saj me vlerën reale të shitjes së tokës ullaiste me vlerë 1.000.000 (një milion) lekë....'

Për sa më sipër, deklaroj me përgjegjësi të plotë që Kontrata e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.2006, me shoqërinë '\*\*\*' sh.p.k., është një kontratë e krijuar me qëllimin për të cilin është përpiluar dhe e revokuar me veprime konkludente, po në vitin 2006 për shkaqet e sipërshtuara.

Në kushtet kur unë hoqa dorë nga blerja e apartamentit pak ditë pas datës 25.8.2006, datë në të cilën kam lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me shoqërinë '\*\*\*' sh.p.k., në datën 31.12.2006, nuk kam pasur ndryshime të interesave private (pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme) nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit 2006.

Në vlerësimin tim, nuk kam pasur detyrimin të deklaroja këtë veprim juridik të revokuar brenda të njëjtit vit kalendarik.

Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2006, në zërin 'Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme', kërkohej (citoj): 'Përshkrimi i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve në çdolloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë (në sasi, numër, lloj, sipërfaqe, adresë të plotë, vitin e krijimit)' dhe në sqarimet mbi këtë zë në deklaratë, ndër të tjera, shënohet (citoj): 'Në tabelë duhet të pasqyroni vetëm ndryshimet (shtesa ose pakësime) të ndodhura në interesat private, të deklaruara më parë, si dhe interesat e lindura nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit...'

Në kushtet kur unë hoqa dorë nga blerja e apartamentit pak ditë pas datës 25.8.2006, datë në të cilën kam lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me shoqërinë '\*\*\*\*' sh.p.k., duke vlerësuar se këto veprime juridike janë kryer brenda të njëjtit vit, duke mos më sjellë në datën 31 dhjetor 2006 ndryshime (shtesa apo pakësime) të interesave private (pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme) nga deklarimi i mëparshëm (31 dhjetor 2005), kam vlerësuar se nuk kam pasur detyrimin për ta deklaruar në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2006.

Po ashtu, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2006, në zërin 'Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë', kërkohej (citoj): 'Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit financiar kërkon shkakun e detyrimit, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), numrin e kontratës dhe interesin bazë, nëse ka: për kreditë bankare duhet kohëzgjatja (muaji/ viti) dhe kësti mujor.'

Në atë vit, unë si subjekt deklarues, në këtë zë kam deklaruar (citoj): 'Në datën 18.9.2006 kam lidhur me 'Raiffeisen Bank', Kontratën e Kredisë Bankare për blerje apartamenti, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. Vlera totale e kredisë është 5.000.000 (pesë milionë) lekë, plus 3 % normë interesi. Data e fillimit të detyrimit ishte 25.9.2006. Afati i kredisë është 168 muaj'.

Në të njëjtin zë kam deklaruar shumën e kredisë së shlyer nga detyrimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe gjendjen e detyrimit deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe me shkrim).

Në deklarimin tim kam shënuar se kredinë bankare e kam marrë për blerje apartamenti, duke plotësuar kështu detyrimin që më kishte lindur në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, 'Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë'.

Pavarësisht faktit që unë hoqa dorë nga apartamenti i porositur në Durrës, shkakun i lëvrimit të kredisë nuk kishte rënë, pasi kredinë të cilën e kisha marrë dhe vijoj ta shlyej rregullisht, e mora me shkakun e vetëm, shkak për të cilin më ishte dhënë, për blerjen e një apartamenti.

Pas marrjes dijeni të këtij fakti nga banka kredituese, ka vijuar normalisht marrëdhënia e kredisë bankare, duke aprovuar kërkesën time për ndryshim kolaterali (garanci hipotekore), me Kontratë Hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.11.2013, të lidhur ndërmjet meje dhe 'Raiffeisen Bank'. Duke qenë se apartamenti në Durrës është një pasuri e pa krijuar prej meje, nuk e kam shënuar në deklaratën 'Vetting' dhe bashkëlidhur po ju dërgoj:

- a) Kontratë Shitjeje (tokë bujqësore) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.4.2005, përpiluar përpara noteres A. S.;
- b) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.5.2020, përpiluar përpara noteres I. V. A.; si dhe
- c) Certifikatë Familjare me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 11.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës \*\*\*, Njësia Administrative Durrës nr. \*\*\*, Bashkia Durrës.

Shuma e lëvruar nga kredia bankare, në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë ka kaluar në llogarinë bankare në 'Raiffeisen Bank' në datën 25.9.2006, dhe është tërhequr cash prej meje më 3.11.2006. Në të njëjtën datë, për qëllim ruajtjeje e kam depozituar në llogarinë e time në 'ProCredit Bank'. Në momentin e kreditimit të vlerës prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, kam deklaruar se burimi i saj është kredia e marrë nga 'Raiffeisen Bank'.



Referuar fletës 'lëvizje llogarie/ AccountStatement' të marrë nga 'ProCredit Bank', unë kam kryer tërheqje nga llogaria ime në këtë bankë, ku në datën 30.4.2007, kjo llogari është zeruar.

Shumën e tërhequr (pra, shumën e kredisë së marrë) e kam mbajtur gjendje cash në banesë, në pritje të realizimit të qëllimit për të cilën kisha marrë kredinë.

Këtë vlerë prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, sikurse kam deklaruar, e kam përdorur në vitin 2009, për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit tim, me adresë: Rr. '\*\*\*\*', nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë.

Është i vërtetë fakti i konstatuar prej jush se në shtator të vitit 2006 kam pasur në bashkëpronësi me prindërit e mi B., dhe I. D., dhe motrën time A. D., dy ambiente dyqane në Durrës, të cilët e kanë origjinën tek apartamenti i privatizuar prej nesh në vitin 1994, dhe i këmbyer me një apartament në katin e parë, i cili është shndërruar në dy njësi shërbimi, dyqane, të cilat janë shitur prej nesh, përkatësisht, në vitet 2007 dhe 2013, ku unë si bashkëpronare kam përfituar pjesën takuese prej 1/4. Referuar pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 5.3.1999, unë isha pa banesë, pasi banesa në të cilën jetoja ishte blerë nga im atë me Kontratë Shitje me Kusht, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, të përpiluar përpara noteres A. S., dhe pronat në të cilat isha bashkëpronare ishin shndërruar në dyqane. Sipas pikës 2 të VKM-së së sipërshënuar, përcaktohet për trajtimin me strehim për funksionarët pa banesë, por jo pa pasuri të paluajtshme dhe konkretisht (citoj): 'Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore të përmendur më sipër janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.'

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se (citoj): 'Subjekti nuk ka deklaruar mbi destinacionin e shumës së tërhequr në vitin 2007 dhe as gjendje cash në banesë, përkatësisht, në vitet 2007 – 2008.', deklaroj me përgjegjësi të plotë se:

Sikurse kam deklaruar në përgjigjet e mia drejtuar jush, duke qenë se kredinë bankare e kam deklaruar në deklaratat e interesave private periodike/vjetore (nga viti 2006 e në vazhdim), në zërin 'detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë', dhe nuk kam kryer asnjë veprim juridik gjatë asaj periudhe, pavarësisht se shumën e kredisë e kam pasur gjendje cash në banesë deri në vitin 2009 e kam vlerësuar si fakt të deklaruar. Nuk e kam vlerësuar se e njëjta shumë duhej deklaruar edhe në një zë tjetër të asaj deklarate, si gjendje cash. Dua të theksoj se kjo pasaktësi nga ana ime ka qenë e paqëllimshme.

Gjithashtu, në Deklaratën e Pasurisë të plotësuar nga ana ime, në zërin 'Deklarimi i pasurisë', pasi kam përshkruar pasurinë time, apartamentin, me adresë: Rr. '\*\*\*\*', nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë, kam deklaruar si burim të krijimit, së pari, kredinë e lëvruar nga 'Raiffesen Bank', sipas Kontratës së Kredisë Bankare dhe Hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstruktion), nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006.

Edhe në zërin 'detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë', kam deklaruar si detyrim kredinë bankare dhe në krah të tij, shumën e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit.

Me të njëjtën logjikë kam vepruar edhe në Deklaratën e Pasurisë (deklaratën 'Vetting'), duke e deklaruar kredinë e marrë me Kontratë Kredie Bankare dhe Hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstruktion) me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.9.2006, në 'Raiffeisen Bank', në dy zëra të deklaratës "Vetting". Edhe pse e kam përdorur në vitin 2009, e kam vlerësuar si shumë të deklaruar nga ana ime.

Për sa më sipër, vlerësoj se veprimet e kryera prej meje janë të qarta dhe mosdeklarimi i gjendjes cash në fund të vitit 2007 ka qenë një pasaktësi e paqëllimshme.

88. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, se (citoj): "Deri në këtë moment në analizën financiare, gjendja e likuiditeteve cash në fund të vitit 2009 dhe 2011 është zeruar sipas deklaramit të subjektit në pyetësor. Ju duhet të shpjegoni bindshëm për Komisionin:

- Lidhur me përdorimin e kësaj shume në vitin 2009 dhe mënyrën e deklarimit të saj në DPV-në e vitit 2009, në raport me detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, lidhur me mënyrën se si duhen deklaruar ndryshimet, duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shitesë dhe pakësim) të interesave pasurore dhe pasurive të tyre.

- Lidhur me përdorimin e kësaj shume në vitin 2011 dhe mënyrën e deklarimit të saj në DPV-në e vitit 2011, në raport me detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, lidhur me mënyrën se si duhen deklaruar ndryshimet, duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shitesë dhe pakësim) të interesave pasurore dhe pasurive të tyre.”, shpjegoj se:

‘Kursimet nga paga për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pasqyrojnë kursimet nga paga për periudhën nga 1 janari i vitit për të cilin i kam deklaruar deri më 31 dhjetor të atij viti. Ato kursime i kam mbartur në vitin pasardhës, por në kushtet që i kam deklaruar në vitin e krijimit, nuk janë rideklaruar përsëri si gjendje cash. Kursimet nga paga, të siguruara prej meje deri në vitin 2009 (duke përfshirë edhe kursimet e atij viti), i kam zeruar në vitin 2009, për pagimin e këstit të parë të blerjes së apartamentit në pronësinë time, në Tiranë, me adresë: Rr. ‘\*\*\*’, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Kodi Postar \*\*\*, Tiranë.

Gjithashtu, kursimet e krijuara në vitet 2010 dhe 2011 i kam zeruar në datën 17.11.2011, kur kam paguar këstin e dytë të blerjes së apartamentit në pronësinë time, në Tiranë, me adresën e sipërshënuar.

Kursimet e deklaruara për vitet 2009 dhe 2011, pavarësisht se nuk i kam pasur gjendje cash në 31 dhjetor të viteve respektive, pasi i kam shpenzuar, (përdorur) si më sipër, i kam deklaruar, pasi me ato kursime kam likuiduar pjesërisht këstet respektive të çmimit të blerjes së apartamentit. Ky ka qenë kuptimi (konceptimi) im në atë kohë për deklarimin e kursimeve duke menduar që do të isha më e qartë nëse do të deklaroja kursimet e vitit të përdorura për blerjet e pasurisë.

89. Lidhur me dhuratë nga prindërit në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, në vitin 2009 sqaroj: ‘Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2009, në zërin ‘dhurata dhe trajtime preferenciale’ kam deklaruar dhuratë nga prindërit B. D., e I. D., në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro. Për shkak të marrëdhënies së posaçme nuk kemi kryer akt noterial, mirëpo këtë veprim juridik prindërit e mi e kanë deklaruar në Deklaratën Noteriale, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 14.4.2011.

Sipas Kontratës së Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.12.2006, im atë, shtetasi B.D., i ka shitur shtetasit Xh. B., apartamentin me sip.130 m<sup>2</sup>, në shumën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë. Gjithashtu, sipas Kontratës së Shitjes me Kusht, datë 15.12.2006, dhe Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2016, im atë ka blerë nga shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k., me administrator z. Q. K., apartament \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup>, kati \*\*\*, Rr. ‘\*\*\*’, në vlerën 5.300.000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë, të paguar në datën 15.12.2006 (mandatpagesë nr. \*\*\*, datë 15.12.2006).

Shuma e dhuruar nga prindërit prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro e ka burimin nga diferenca midis shitjes së apartamentit 3+1, ndërtuar nga firma ‘\*\*\*’ sh.p.k., kundrejt shtetasit Xh. B., në datën 4.12.2006, në shumën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë dhe blerjes së apartamentit 2+1, ndërtuar nga firma ‘\*\*\*’ sh.p.k., në datën 15.12.2006, në shumën 5.300.000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë. Diferenca ndërmjet vlerës së shitjes së apartamentit 3+1 me apartamentin 2+1 është 3.700.000 (tre milionë e shtatëqind mijë) lekë.

Si apartamenti që im atë, shtetasi B. D., i ka shitur shtetasit (të ndjerit Xh. B.), ashtu edhe ai i blerë nga firma ‘\*\*\*’ sh.p.k., në datën 15.12.2006, edhe aktualisht, janë apartamente të paregjistruara në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës) nga shoqëritë respektive të ndërtimit.

Pallati ku ndodhet apartamenti me sip. 110 m<sup>2</sup>, i cili zotërohet nga im atë B. D., është në krah të pallatit në të cilin ndodhej apartamenti që babai i ka shitur shtetasit Xh. B., ndaj kanë të njëjtën adresë: Rr. '\*\*\*', lagjja nr. \*\*\*, Durrës. Me përditësimin e adresave nga pushteti lokal, rruga '\*\*\*' u emërtua rruga '\*\*\*' (aktualisht të dyja këto pallate janë të pabanueshme për shkak të dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 që goditi vendin tonë, e veçanërisht qytetin e Durrësit).

Shuma prej 7.000.000 (shtatë milionë) lekësh, siç ka rezultuar nga dokumentacioni bankar i administruar nga Komisioni, e kaluar në datën 27.11.2006, si llogari hyrëse në numrin e llogarisë që ka pasur im atë te 'ProCredit Bank', me përshkrimin 'transfertë personale M. A., ose M. N., – likuidim blerje apartamenti', përfaqëson një pjesë të vlerës së shitjes së apartamentit të sipërshënuar shtetasit Xh. B., prej 9.000.000 (nëntë milionë) lekësh.

Shtetasja N. M., e datëlindjes 20.3.1972, është e bija e shtetasit (tashmë të të ndjerit) Xh. B., i datëlindjes 14.6.1950, pra, është e bija e blerësit të apartamentit nga im atë.

Shtetasi A. M., i datëlindjes 26.1.1969, është bashkëshorti i shtetases N. M., pra, bashkëshorti i vajzës (dhëndri) i blerësit Xh. B., [provuar me Certifikatë Familjare, me nr. serie \*\*\*, si dhe Certifikatë Martese (nga akti), me nr. serie \*\*\*, të lëshuara në datën 24.3.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Elbasan].

90. Lidhur me burimin e blerjes së apartamentit në vlerën 48.000 (katër mijë e tetëqind) USD në datën 20.8.2003, i cili pas rishitjes në vitin 2006, ka shërbyer si burim për dhurimin e shumë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, sqaroj: 'Sipas Kontratës së Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, im atë ka blerë (porositur) nga '\*\*\*' sh.p.k., apartamentin 3+1, me sip. 130 m<sup>2</sup>, në vlerën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD (ose 5.217.120 lekë), nga të cilat kësti i parë 24.000 (njëzet e katër mijë) USD është paguar ditën e lidhjes së kontratës në praninë e noterit, ndërsa kësti i dytë 24.000 USD do të paguhej gjatë periudhës 2-vjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë.

Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj prone, janë:

a) të ardhurat e mia, shtetases Etleva Deda (deri në fund të vitit 2004);

b) të ardhurat e prindërve të mi B. dhe I. D., (deri në fund të vitit 2004); si dhe

c) të ardhurat e sime motre, shtetases A. D., (për periudhën janar 1994 – gusht 2000).

Të ardhurat e mia janë të ardhurat nga paga si zv/gjyqtare dhe gjyqtare, të ardhurat e motrës sime, shtetases A. D., janë të ardhura nga paga si arsimtare (mësuese e ciklit të ulët në shkollën 8-vjeçare '\*\*\*', Plazh, Durrës), si dhe të ardhurat e prindërve të mi nga aktiviteti tregtar i prindërve (nënës I. D., për periudhën 1994 – 2002 dhe babait B. D., për periudhën 2002 – 2004).

Të ardhura nga aktiviteti tregtar i z. I. D., (për periudhën 1994 – 2002). Nëna ime ka ushtruar aktivitet tregtar biznes i vogël 'tregti artikuj të ndryshëm industrialë', me kod fiskal \*\*\*, me adresë: Rr. '\*\*\*', nr. \*\*\*, lagjja nr. \*\*\*, Durrës, për periudhën 1994 – 2002. Në deklaratën 'Vetting' ka deklaruar të ardhurat sipas vërtetimit të marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, ku pasqyrohen vetëm të ardhurat bruto, dhe jo ato neto. Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2016, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, jepen të dhëna mbi aktivitetit tregtar të tatimpagueses (nënës sime) I. (I.) D.

Të ardhura nga aktiviteti tregtar i babait B. D., (për periudhën 2002 – 2004). Babai im ka ushtruar aktivitet tregtar biznes i vogël 'tregti artikuj të ndryshëm industrialë', me NIPT \*\*\*, me adresë: Rr. '\*\*\*', nr. \*\*\*, lagjja nr. \*\*\*, Durrës, për periudhën 2002 – 2008. Në deklaratën 'Vetting' ka deklaruar të ardhurat, ku pasqyrohen vetëm të ardhurat bruto (qarkullimi).

Sipas Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, im atë figuron i regjistruar si tatimpagues me NIPT \*\*\* dhe nuk ka detyrime tatimore të pashlyera.

*Për llogaritjen e të ardhurave neto të biznesit të prindërve të mi jam mbështetur në metodën alternative të llogaritjes, duke u nisur nga të dhënat për vitet 2016, 2017 dhe 2018, ku qarkullimi dhe fitimi neto kanë qenë të deklaruara. Mesatarja e normës së fitimit në raport me qarkullimin për këto vite ka qenë 34.45 %, siç mund të shikoni dhe në dokumentet bashkëngjitur.*

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Norma e fitimit
2016	1,697,700	569,159	33.52
2017	1,918,300	634,159	33.05
2018	1,392,850	512,122	36.76
Mesatarja e tre viteve			34.45

*Po paraqes pasqyrën e të ardhurave të familjes sime, për periudhën 1994 – 2004, ku përfshihen të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve, nga paga ime dhe e sime motre A. D.:*

VITI	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	TOTAL
Qarkullimi I. D., (Kod Fiskal ***)	200,650	254,580	315,580	334,390	348,310	1,275,400	1,422,900	1,486,000	525,000	0	0	6,162,810
Qarkullimi B. D. (NIPT***)	0	0	0	0	0	0	0	0	568,000	1,100,000	1,500,000	3,168,000
Total Qarkullimi	200,650	254,580	315,580	334,390	348,310	1,275,400	1,422,900	1,486,000	1,093,000	1,100,000	1,500,000	9,330,810
Total neto (prinderit 34.45%)	69,124	87,703	108,717	115,197	119,993	439,375	490,189	511,927	376,539	378,950	516,750	3,214,464
Të ardhura nga paga	132,093	141,165	165,216	167,760	236,093	261,556	396,651	452,830	492,844	607,643	1,387,860	4,441,711
Etleva Deda												0
Të ardhura nga paga A. D.	40,724	57,891	82,164	84,540	109,941	118,315	95,693	0	0	0	0	589,268
Të ardhura neto total	241,941	286,759	356,097	367,497	466,027	819,246	982,533	964,757	869,383	986,593	1,904,610	8,245,443
Shpenzime jetese	120,000	130,000	140,000	190,000	250,000	320,000	375,456	375,456	375,456	375,856	375,856	3,028,080
Rezultati me 34.45%	121,941	156,759	216,097	177,497	216,027	499,246	607,077	589,301	493,927	610,737	1,528,754	5,217,363

91. Në lidhje me kërkesën e Komisionit se (citoj): "Ju duhet të shpjegoni bindshëm mundësinë financiare të prindërve për blerjen e pasurisë në shumën 5.217.120 (pesë milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet), duke shpjeguar cili ka qenë marzhi i fitimit nga aktiviteti tregtar dhe shpenzimet e tyre jetike, si dhe të provoni me dokumentacion ligjor pagimin e tatimit mbi fitimin nga shitja e apartamentit 3+1 me sip. 130 m<sup>2</sup>, blerë në shumën 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD në vitin 2003, dhe shitur në vitin 2006, në shumën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë.", jap shpjegimet e mia të mbështetura në prova, si më poshtë:

*'Në Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, të përpiluar përpara noterës A. S., është përcaktuar, ndër të tjera se (citoj):*

*'Shoqëria e ndërtimit '\*\*\*' sh.p.k., sipas lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 28.3.2003, po realizon një ndërtim pallat shumëkatësh, me sipërfaqe ndërtimi prej 412 m<sup>2</sup>.*

*Nga ky ndërtim shoqëria '\*\*\*' sh.p.k., do t'i shesë shtetasit B. D., një apartament të ndodhur në katin e pestë të ndërtimit (kati i katërt i banimit), i përbërë nga tri dhoma dhe një kuzhinë, me ambiente ndihmëse me sipërfaqe përafërsisht 130 m<sup>2</sup>, me pamje nga ana lindore e pallatit.*

*Çmimi i apartamentit do të jetë 48.000 (dyzet e tetë mijë) USD. Këtë shumë shtetasi B. D., do ta likuidojë në këtë mënyrë:*

- *kësti i parë në vlerën prej 24.000 (njëzet e katër mijë) USD u likuidua në dorë në zyrën e noterisë Durrës, në praninë e noterit;*
- *kësti i dytë në shumën prej 24.000 (njëzet e katër mijë) USD do të likuidohet gjatë periudhës dyvjeçare deri në dorëzimin e çelësave në dorë.*

*Me regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive Durrës të ndërtimit të realizuar nga shoqëria '\*\*\*' sh.p.k., shtetasit B. D., i lind e drejta e realizimit të kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit në zyrën e regjistrimit të pasurive Durrës, me shpenzimet e veta.'*

*Nga përmbajtja e kësaj kontrate, e cila ngjason me kontratën e sipërmarrjes (neni 850 i Kodit Civil) rezulton se në datën 20.8.2003, im atë i ka paguar shoqërisë së ndërtimit '\*\*\*' sh.p.k., vetëm këstin e parë prej 24.000 (njëzet e katër mijë) USD.*

*Edhe pse ne kemi banuar në apartamentin e porositur që në tremujorin e parë të vitit 2004 (në mars të atij viti), këstin e dytë, im atë e ka paguar në fund të vitit 2004.*

*Në kushtet kur apartamenti edhe aktualisht është i paregjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës (sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës) nga shoqëria e ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., ende nuk është kryer kontrata përfundimtare e shitblerjes.*

*Për t’jua provuar faktin se pagesa e këstit të dytë të apartamentit nga im atë është kryer në fund të vitit 2004, në datën 12.5.2020, kam kërkuar nga administratori i vetëm dhe ortak i ish-shoqërisë së ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., (aktualisht shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k., është e çregjistruar), shtetasi F. F., lëshimin e një deklarate noteriale.*

*Në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.5.2020, me cilësinë e administratorit të vetëm dhe ortakut të shoqërisë së ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., shtetasi F. F., ka deklaruar përpara noteres I. V. A., ndër të tjera se (citoj):*

*‘...deklaroj se shtetasi B. D., në lidhje me apartamentin 3+1, me sip. 130 m<sup>2</sup>, ka likuiduar totalisht shumën prej 48.000 USD, ku 24.000 USD i ka paguar në datën 20.8.2003, kur kemi lidhur Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. Këstin e dytë të çmimit të apartamentit e ka paguar në fund të vitit 2004, duke respektuar afatin 2 – vjeçar parashikuar në kontratë. Banesën e ka marrë në dorëzim në pranverën e vitit 2004. Ortaku tjetër i ish-shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., i ndjeri Q. K., ka ndërruar jetë, ndaj këtë deklaratë po e lëshoj i vetëm në emër të shoqërisë.’*

*Për sa më sipër, në ndryshim nga përllogaritja e kryer nga Komisioni, duke qenë se kësti i dytë prej 24.000 (njëzet e katër mijë) USD është paguar në fund të vitit 2004, për llogaritjen e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj prone, duhet të llogariten edhe të ardhurat e mia e të prindërve të mi të vitit 2004.*

*Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj prone janë edhe të ardhurat e sime motre, shtetases A. D., për periudhën janar 1994 – gusht 2000, të cilat nuk janë përllogaritur nga Komisioni.*

*Sipas Certifikatës Familjare, me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 6.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës, \*\*\*, Njësia Administrative Durrës \*\*\*, vërtetohet se sipas regjistrimit themeltar të vitit 1974, ime motër, A. D., e datëlindjes 14.7.1974, figuron në të njëjtin trung familjar me mua, prindërit dhe motrën e vogël, L. D.*

*Sipas Certifikatës së Martesës, me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 6.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile (Durrës, \*\*\*, Njësia Administrative Durrës \*\*\*), vërtetohet se ime motër A. D., në bazë të Aktit nr. \*\*\*, ka lidhur martesë me shtetasin A. A., në datën 29.12.1999. Në kushtet kur shtetasi A. A., ishte dhe është emigrant në Itali, me kryerjen e dokumenteve për bashkim familjar, në verën e vitit 2000, A. A. (D.) u largua nga banesa (familja e vajzërisë). Fakti që shtetasit A. A. D., dhe A.A., aktualisht janë rezidentë në shtetin italian ka rezultuar i provuar nga dokumentacioni i depozituar prej meje pranë jush gjatë hetimit administrativ.*

*Referuar ‘vërtetim mbi bazën e vlerësueshme’ për të siguruarën A. B. D., të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës (dy fletë), vërtetohet fakti se A. B. D., ka punuar në periudhën 1.10.1993 – 31.12.2000 (kur është larguar), si dhe ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore.*

*Për sa më sipër, referuar pasqyrës, të ardhurat neto të familjes për periudhën 1.1.1994 – 31.12.2004, kanë qenë në vlerën 8.245.443 lekë (tetë milionë e dyqind e dyzet e pesë mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë.*

*Në lidhje me shpenzimet jetike, deklaroj se kanë qenë modeste, për vetë kohën dhe objektivat që kishin prindërit e mi që të krijonin një bazë për të ardhmen.*

*Fakti që jetonim në Durrës bënte që edhe pushimet t’i kalonim në Durrës, duke mos u larguar në ndonjë destinacion tjetër. Në tabelën më sipër kam pasqyruar shpenzimet e përafërta të familjes sime në qytetin e Durrësit (duhet të merret në konsideratë edhe fakti se jetesa në Durrës është më e lirë se jetesa në Tiranë).*

Vlera e apartamentit ka qenë 5.217.120 (pesë milionë e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekë. Është e qartë se familja ime ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit.

Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, me lëndë 'kthim përgjigje', të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, informohem ndër të tjera, se (citoj):

'...tatimi mbi fitimin e kalimit të pronësisë si detyrim që buron nga udhëzimi nr. \*\*\*, datë 30.7.2018, paguhet prej shitësit për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Për pasuritë e paregjistruara ky tatim paguhet në momentin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme pranë ZVRPP-së, sot, DVASHK-ja.

Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot, DVASHK llogarisin dhe e arkëtojnë detyrimin tatimor përkatës sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr. \*\*\*, datë 30.7.2018.

Pagesa e detyrimit bëhet në momentin e regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme.'

Menjëherë pas shitjes së apartamentit 3+1 me sip. 130 m<sup>2</sup>, im atë është interesuar në ish- ZVRPP-në Durrës, duke e njohur si detyrim të shitësit pagimin e tatimit mbi fitimin për kalimin e pronësisë, por prej tyre ka marrë përgjigjen se nuk i ka lindur ende ai detyrim, për aq kohë sa pasuria objekt shitjeje nuk është regjistruar në ZVRPP-në Durrës. Me lindjen e së drejtës për të paguar tatimin mbi fitimin, pra, me regjistrimin e pronës (apartamentit) së shitur, detyrimi do të shlyhet sipas ligjit dhe akteve normative në fuqi.

Bashkëlidhur subjekti dërgon:

- a) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.5.2020, lëshuar përpara noteres I. V. A., Dhoma e Noterisë Durrës;
- b) Certifikatë Familjare me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 6.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës, \*\*\*, Njësia Administrative Durrës nr. \*\*\*;
- c) Certifikatë Martese me nr. serie \*\*\*, të lëshuar në datën 6.5.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile (Durrës, \*\*\*, Njësia Administrative Durrës \*\*\*;
- ç) vërtetim mbi bazën e vlerësueshme, për të siguruarën A. B. D., të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës (dy fletë);
- d) tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për vitet 2016, 2017 dhe 2018, për tatimpaguesin B. D., nxjerrë elektronikisht nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (tre fletë);
- dh) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, me lëndë 'kthim përgjigje', të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës.

92. Lidhur me të ardhura në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë nga shitja e njësisë së shërbimit në vitin 2007, sqaroj: 'Në kuadër të privatizimit të banesave shtetërore, në datën 11.4.1994, unë së bashku me prindërit dhe me motrën A. D., kemi privatizuar apartamentin ku banonim, me sipërfaqe 77,35 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. '\*\*\*\*', p. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, z.k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, Durrës.

Në datën 25.3.2004, apartamentin në pronësinë tonë (të sipërshënuar) e kemi shkëmbyer me apartamentin në bashkëpronësi të shtetasve Sh.D., L.D., dhe O.D., dhe konkretisht, me apartamentin 2+1, me sip. 73,85 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. '\*\*\*\*', p. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, z.k. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, Durrës, pasqyruar ky veprim juridik në Kontratën e Shkëmbimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., të përpiluar në datën 25.3.2004, përpara noteres M. N.

Sipas vërtetimit 'nga dokumentet hipotekor', të lëshuar në datën 27.4.2004, nga ZVRPP-ja Durrës, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.4.2004, është regjistruar në pronësi të familjes Deda, pasuria e shkëmbyer me familjen D.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.4.2006 të Këshillit të Rregullim Territorit të Bashkisë Durrës për ndryshim destinacioni, kjo pasuri është kthyer nga apartament banimi në dy ambiente shërbimi, me sip. 47.7 m<sup>2</sup> dhe 26.15 m<sup>2</sup>.

Sipas Kontratës së Shitjes (dyqan) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.12.2007, unë së bashku me familjarët i kemi shitur shtetasit F. Ç., pasurinë dyqan nr. \*\*\*, me sip. 26,15 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. '\*\*\*', lagjja \*\*\*, k. \*\*\*, p. \*\*\*, Durrës, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, duke marrë pjesën takuese prej 1/4, në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Të gjitha veprimet juridike të sipërshënuara i kam deklaruar në deklaratat e interesave periodike vjetore në vitet respektive, si dhe në deklaratën 'Vetting', unë edhe im atë, shtetasi B. D.

Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore për vitin 2009, në zërin 'Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme', sikurse e citova me lart, kërkohej:

'Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhet, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdolloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit'.

Në respektim të asaj që kërkohet në deklaratën e interesave private periodike/vjetore, kam bërë deklarin mbi shitjen e kryer në vitin 2007, duke përcaktuar hollësisht llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhet, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë, dokumentacionin, çmimin e shitjes, si dhe pjesën takuese. Duke shënuar pjesën takuese nga shuma e përfituar nga çmimi i shitjes, e kam vlerësuar si deklarim konform detyrimit sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

Duke e deklaruar shumën prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, si e ardhur e vitit 2007 (e deklaruar), kam vlerësuar se nuk duhej rideklaruar në vitet 2008 dhe 2009.

Mbi shitjen e pasurisë dyqan, me sip. 26,15 m<sup>2</sup>, në Durrës, në vitin 2007, im atë ka paguar në datën 26.12.2007, tatim mbi fitimin në shumën 5.000 (pesë mijë) lekë. Për të provuar këtë fakt kam tërhequr në datën 7.5.2020, nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, dokumentacionin e plotë, me referencë \*\*\*, ku në formularin përkatës pasqyrohet shuma prej 5.000 (pesë mijë) lekësh, e cila është arkëtuar me mandatarëkëtimin nr. \*\*\*, datës 26.12.2007.

Bashkëlidhur po ju dërgoj dokumentacionin e plotë, me referencë \*\*\*, tërhequr në datën 7.5.2020, në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) fletë.

93. Lidhur me dhuratë nga babai B. D., të vlerës 4.000 (katër mijë) euro, në vitin 2011, sqaroj: 'Sikurse kam deklaruar, në datën 17.11.2011, im atë më ka dhuruar shumën 4.000 (katër mijë) euro, fakt për të cilin ka lëshuar Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011, në të cilën deklaron se më ka dhuruar shumën e sipërshënuar me qëllim blerjen e apartamentit në Tiranë (datë në të cilën kam paguar këstin e dytë të apartamentit, sikurse është shpjeguar më lart). Si burim për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e babait nga puna e tij ndër vite, nga aktiviteti privat – dyqan dhe nga shitja e apartamenteve.

Duke vlerësuar qarkullimin e realizuar nga aktiviteti tregtar i babait tim (sipas informacionit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës), konstatohet se ai ka pasur mundësi financiare për dhurimin e kësaj shume.

94. lidhur me hua në vlerën 8.000 (tetë mijë) euro, marrë në vitin 2011, nga shtetasja H. D., sqaroj: 'Për të paguar këstin e dytë të blerjes së apartamentit në pronësinë time, në Tiranë, në datën 17.11.2011, i kam marrë hua shtetasës H. D., (vjehrrës së xhaxhait tim, shtetasit B. D.,) shumën prej 8.000 (tetë mijë) euro. Këtë veprim juridik e kemi pasqyruar në Kontratën e Huas, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011, të përpiluar përpara noteres M. N.

Shtetasja H. D., e dispononte këtë shumë, pasi në datën 5.4.2010, i ka shitur shtetasit O. S., apartamentin në pronësi të saj, të ndodhur në rrugën '\*\*\*', lagjja nr. \*\*\*, , Durrës, në vlerën

4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, fakt i cili pasqyrohet në Kontratën e Shitblerjes së apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.4.2010, të përpiluar përpara noterës A. S., Dhoma e Noterisë Durrës.

Sikurse e kam deklaruar, unë Etleva Deda, prindërit e mi I. D., e B. D., si dhe ime motër A. D. (A.), si bashkëpronarë në pjesë të barabartë dhe të pandarë në pasurinë e paluajtshme, të llojit 'njësi', me nr. pasurie \*\*\*, në z.k. \*\*\*, me sip. 47 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. '\*\*\*\*', lagjja nr. \*\*\*, p. \*\*\*, në Durrës kemi përpiluar Kontratën e Shitblerjes me Rezervë – me afat, ku pasurinë e sipërshënuar, ua kemi shitur shtetasve A. Ç., dhe E. Ç., për çmimin prej 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro. Kjo shumë është likuiduar prej tyre pjesërisht në datën e përpilimit të kësaj kontrate, datë 27.7.2013, dhe totalisht në datën 14.8.2013, ku unë kam marrë pjesën takuese 25 %, prej 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro.

Me këtë shumë parash të përfituar nga shitja e njësisë kam likuiduar shtetasen H. D., duke i shlyer të gjithë shumën prej 8.000 (tetë mijë) euro, të marrë hua me Kontratën e Huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.11.2011. Për këtë, shtetasja H. D., ka lëshuar përpara së njëjtës noterë. Deklaratën Noteriale, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.8.2013.

Me shumën 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, të përfituar nga shitja e dyqanit prej 47.7 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së datës 27.7.2013, kam shlyer huan e marrë në vitin 2011, për pagimin e këstit të dytë të blerjes së apartamentit në pronësinë time, në Tiranë.

95. Në lidhje me kërkesën e Komisionit (citoj): “Deri në këtë moment, në analizën financiare, gjendja e likuiditeteve cash në fund të vitit 2013 është pasqyruar sipas deklaramit të subjektit në pyetësor, duke zbritur nga të ardhurat e përfituara nga shitja e njësisë së shërbimit shumën prej 8.000 (tetë mijë) euro. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë bindshëm lidhur me përdorimin e kësaj shume në vitin 2013 dhe mënyrën e deklaramit të saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, në raport me detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, lidhur me mënyrën se si duhen deklaruar ndryshimet, duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shitesë dhe pakësim) të interesave pasurore dhe pasurive të tyre.”, jap shpjegimin tim se:

‘Nga shuma 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, e përftuar nga shitja e pasurisë së paluajtshme, të llojit ‘Njësi’, me nr. pasurie \*\*\*, në z.k. \*\*\*, me sip. 47 m<sup>2</sup>, në datën 14.8.2013, kam marrë pjesën takuese 25 %, prej 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro.

Duke çmuar se në Deklaratën e Interesave Periodike/Vjetore për vitin 2013 kam deklaruar veprimin juridik të shitjes sipas Kontratës së Shitblerjes me Rezervë – me afat, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.7.2013 dhe sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2013, si dhe veprimin juridik kthim huaje shtetasës H. D., sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.8.2013, si dhe duke dorëzuar dokumentacionin justifikues, kam vlerësuar se kam shënuar shtesat dhe pakësimet për atë vit deklarimi. Shuma e mbetur prej 5.750 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro është pasojë (rezultat) e këtyre dy veprimeve juridike të deklaruara, të cilën e kam mbartur në vitin pasardhës (2014).

96. Lidhur me të ardhurat në shumën 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro nga shitja e njësi shërbimi në vitin 2013, shpjegoj: ‘Sikurse e kam deklaruar dhe e shpjegova edhe më lart, unë së bashku me familjarët e mi, nga shitja e pasurisë të llojit “Njësi”, me sip. 47 m<sup>2</sup>, pasqyruar në Kontratën e Shitblerjes me Rezervë – me afat, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.7.2013, si dhe në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2013, kemi marrë shumën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, duke marrë pjesën takuese prej 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro.

Burimi i kësaj prone është i njëjtë me burimin e pronës së shitur shtetasit F. Ç., (shpjeguar hollësisht më lart). Në datën 5.7.2013 është kryer rivlerësimi i pasurisë sipas aktekspertimit në shumën 7.980.000 (shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.



Në lidhje me kërkesën e Komisionit (citoj): ‘Subjekti duhet të shpjegojë bindshëm për Komisionin lidhur me mënyrën e deklarimit të shumës 13.750 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, e cila ka qenë shuma cash e të ardhurave, të cilat janë mbartur në vitin 2014, në raport me detyrimin sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, lidhur me mënyrën se si duhen deklaruar ndryshimet, duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shitesë dhe pakësim) të interesave pasurore dhe pasurive të tyre’.

Jap shpjegimin tim se: ‘... duke çmuar se në Deklaratën e Interesave Periodike/Vjetore për vitin 2013 kam deklaruar veprimin juridik të shitjes sipas Kontratës së Shitblerjes me Rezervë – me afat, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.7.2013, Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 14.8.2013, si dhe veprimin juridik kthim huaje shtetases H. D., sipas Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.8.2013, si dhe duke dorëzuar dokumentacionin justifikues, kam vlerësuar se kam shënuar shtesat dhe pakësimet për atë vit deklarimi.

Shuma e mbetur prej 5.750 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro është rezultat i këtyre dy veprimeve juridike të deklaruara, të cilën e kam mbartur në vitin pasardhës.’

97. Në lidhje me konstatimet e Komisionit se (citoj): “Kontrata me shoqërinë e ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., në datën 25.8.2006, ka qenë një veprim fiktiv, i krijuar për përfitimin e kredisë”, shpjegoj se: ‘Si qytetare e Republikës së Shqipërisë dhe për më tepër si gjyqtare, nuk është në moralin tim kryerja e një veprimi fiktiv, cilado qoftë pasoja juridike që sjell. Qëndrimin tim në lidhje me Kontratën e Sipërmarrjes, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.2006, lidhur me shoqërinë e ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., për blerjen e një apartamenti me sip. 132,5 m<sup>2</sup>, me çmimin 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë në adresën: Rr. ‘\*\*\*’, lagjja nr. \*\*\*, Durrës, e kam shprehur edhe gjatë hetimit administrativ edhe në këtë material shpjegues, dokumentuar me prova.

Duke vlerësuar se për mbarëvajtjen e punës dhe të jetesës sime do të ishte më mirë blerja e një apartamenti banimi në Tiranë dhe jo në Durrës, marrë shkas nga distanca vendi i punës-banesë, nga ngarkesa në punë dhe natyra e gjykimeve që kishte për kompetencë lëndore gjykata, ku unë ushtrroja funksionin si gjyqtare (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda) kam hequr dorë nga blerja e apartamentit në Durrës, duke i dhënë të drejtën shoqërisë së ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k., t’ia shesë kujtdo shtetasi tjetër, me qëllimin për të blerë apartament në Tiranë.

Sqaroj se unë hoqa dorë nga blerja e apartamentit në Durrës, por jo nga qëllimi për të cilin më ishte lëvruar kredia bankare.

Për sa më sipër, deklaroj me përgjegjësi të plotë që Kontrata e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.8.2006, me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., është një kontratë e krijuar me qëllimin për të cilin është përpiluar dhe e revokuar me veprime konkludente, po në vitin 2006 për shkaqet e sipërshënuara.

Në përgjigje të konstatimit tuaj, në datën 8.5.2020, kam marrë nga shtetasi F. F., një Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.5.2020, dhënë përpara noteres I. V. A., e cili konfirmon këtë fakt.

Në vlerësimin tim, nuk kam pasur detyrimin të deklaroja këtë veprim juridik të revokuar brenda të njëjtë vit kalendarik.

98. Në lidhje me kërkesën e Komisionit (citoj): “Subjekti nuk ka deklaruar (DPV) lidhur me destinacionin e shumës së tërhequr në vitin 2007 dhe as gjendje cash në banesë përkatësisht në vitet 2007 – 2008, duke mbetur kështu i paqartë burimi i të ardhurave në shumën 5.000.000 (pesë milionë) përdorur në vitin 2009 për blerjen e apartamentit.”, jap shpjegimin tim se:

Sikurse kam deklaruar faktin e mbajtjes së shumës së kredisë në gjendje cash në banesë, në vitet 2007 – 2008, e kam vlerësuar si fakt të deklaruar, duke qenë se kredinë bankare e kam deklaruar në Deklaratat e Interesave Private Periodike/Vjetore, nga viti 2006 deri më sot, në zërin ‘Detyrime

*Financiare Ndaj Personave Juridikë dhe Fizikë’, si edhe për faktin se unë nuk kam kryer asnjë veprim juridik gjatë asaj periudhe.*

*Vlerësoj se deklaratimet e mia shpjegojnë qartë veprimet e kryera prej meje dhe pasakatësia në mosdeklarimin e gjendjes cash ka qenë e paqëllimshme”.*

**99. Në përfundim,** trupi gjykues vlerëson se pavarësisht pasaktësive të konstatuara në deklaratimet periodike vjetore, lidhur me deklaratimin mbi gjendjen *cash* dhe kundërshtive të konstatuara mes të dhënave lidhur me deklaratimin e gjendjes deri më 31 dhjetor dhe deklaratimit nga vetë subjekti mbi përdorimin e kursimeve për blerjen e apartamentit, i cili është në një datë më të shpejtë, të gjitha faktet e servitura mbeten të lidhura mes tyre dhe justifikojnë deklaratimet e subjektit se ato kursime janë përdorur për blerjen e apartamentit (pagimin e kësteve përkatëse).

100. Nëse ndjekim logjikën e deklaratimeve ndër vite dhe atë “Vetting” lidhur me gjendjen *cash*, deklaratimet e znj. Etleva Deda, përgjatë procesit të rivlerësimit të saj gjejnë harmoni me situatën e pasqyruar në deklaratimin “Vetting”. Nga vëzhgimi i deklaratave periodike evidentohet se pas pagimit të kësteve të apartamentit përkatësisht në vitin 2009 dhe 2011, subjekti nuk ka deklaruar më kursime dhe as gjendje *cash* dhe në vijim vjen në deklaratën “Vetting” pa kursime dhe gjendje *cash* në banesë. Situata e cila vjen në harmoni me logjikën e shpjegimeve të subjektit, pasi nëse kursimet nuk do të ishin përdorur, apo nga Komisioni nuk do të pranoheshin shpjegime bindëse, do të kishim një analizë financiare të çekuilibruar, ku gjendja *cash* e deklaruar më herët, e papranuar si e përdorur në vitet 2009 – 2011, do të ishte akumuluar si gjendje *cash* në vitin 2017, dhe do të ishte në kundërshti me deklaratimin “Vetting” të subjektit të rivlerësimit.

101. Pranimi i shpjegimeve të subjektit, gjen harmoni me mënyrën se si ajo deklaroi në DPV, ku subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi pakësime apo shtesa sipas detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003 dhe në vijim, nëse gjendja *cash* nuk do të ishte përdorur, siç ajo shpjegon se ka ndodhur, këto kursime do të duhej të ishin deklaruar si gjendje *cash* në deklaratimin “Vetting”.

102. Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj.

102. Në vlerësim të deklaratimeve dhe fakteve të prezantuara më sipër, Komisioni çmon se situata faktike nuk është deklaruar saktë në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, nga subjekti i rivlerësimit.

103. Në vlerësim të sa më sipër, megjithëse Komisioni i gjen deklaratimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen *cash* dhe përdorimin e tyre, jo në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, në përfundim vlerëson se ato janë pasaktësi të paqëllimshme dhe se deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting” ndihmojnë për të kuptuar drejt deklaratimet e tij ndër vite.

104. Lidhur me shumën prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, të përfituar për blerje apartamenti, sipas Kontratës së Sipërmarrjes, nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., për një apartament me sip. 132,5 m<sup>2</sup>, në adresë: Rr. “\*\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, Durrës, e cila ka shërbyer për të legjitimuar përfitimin e kredisë së butë nga “Raiffeisen Bank”, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit dhe fakteve të rezultuara gjatë hetimit, Komisioni vlerëson se nuk jemi përpara një kontrate fiktive në kuptim të parashikimit për fiktivitetin, sipas nenit 92, të Kodit Civil, ku parashikohet: “*Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike*”.

105. Duke analizuar veprimet e njëpasnjëshme konstatohet se subjekti dhe shoqëria kanë rënë dakord të zgjidhin kontratën e mësipërme, për shkak se subjekti ka synuar blerjen e apartamentit në Tiranë, ku ajo ushtronte edhe detyrën e gjyqtarit. Megjithëse nuk ka një marrëveshje me shkrim

mes palëve, nga hetimi ka rezultuar se mes tyre ka ekzistuar pëlqimi i ndërsjellë për prishjen apo anulimin e kontratës së porosisë, pasi nga shoqëria ndërtuese nuk ka pasur asnjë pretendim dhe po ashtu nga hetimi ka rezultuar se ky apartament është blerë nga një shtetase tjetër duke shuar çdo dyshim të mundshëm lidhur me këtë pasuri.

106. Nga ana tjetër kredia e marrë ka krijuar mundësinë për lidhjen e Kontratës së Porosisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.10.2009, te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për një apartament banimi, me sip. 115 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, në Tiranë, ku ndodhej edhe vendi i punës së subjektit të rivlerësimit. Si financim për blerjen e kësaj pasurie, ka shërbyer shuma prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, e cila rezulton se është paguar menjëherë nga subjekti i rivlerësimit dhe është deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009.

107. Pavarësisht kompleksitetit të realizimit të këtyre veprimeve juridike të sipërcituara mes palëve dhe vështirësisë për të kuptuar mekanizmin e tyre, nuk konstatohen në këto veprime elemente që mund të shkaktojnë pavlefshmëri apo kundërshti me urdhërimet e parashikuara në ligj.

Në vlerësim të tërësisë së veprimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni analizon se vlerësimi i këtyre veprimeve me natyrë civile duhet analizuar në frymën e ligjit nr. 84/2016, për të konstatuar nëse gjenden elemente të tillë që tregojnë përpjekjeje për të kamufluar veprime të subjektit të rivlerësimit që vijnë ndesh me urdhërimet ligjore në fuqi, e të cilat synojnë përpjekje për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme, apo për të mbuluar deformimet në deklaratimet e bëra në deklaratën “Vetting”, qofshin ato fshehje të pasurive apo deklarime të rreme.

108. Duke analizuar veprimet e njëpasnjëshme të subjektit të rivlerësimit, në analizë të fakteve dhe të konkluzioneve të arritura nga hetimi administrativ i Komisionit, arrihet në përfundimin se znj. Etleva Deda është përfshirë në një sërë veprimesh juridike që kanë ndjekur dhe afektuar njeri-tjetrin, duke krijuar të drejta e marrë përsipër detyrime, në funksion të një qëllimi që është vlerësuar si objekt kontrolli e verifikimi mbi ligjshmërinë e tij në kuptim të këtij procesi, i cili është financimi i blerjes së një apartamenti banimi, në të cilin banon, nëpërmjet përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese, e subvencionuar nga organet shtetërore për një kategori funksionarësh publikë, në të cilët bëjnë pjesë edhe gjyqtarët.

109. Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2008, lidhur me pasqyrimin e gjendjes *cash* në banesë të shumës së marrë kredi, nuk mund të konsiderohen si të tilla që të ngrenë dyshime mbi ekzistencën apo ligjshmërinë e këtij burimi, për aq kohë sa provohej se ajo shumë e *disbursuar* prej “Raiffeisen Bank” në vitin 2006 është transferuar në “Credins Bank” dhe tërhequr *cash* nga subjekti në vitin 2007, disponohej në fund të atij viti pasi nuk rezulton e shpenzuar as në deklaratimet periodike dhe as gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Po ashtu, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si detyrim, nëpërmjet deklaratave periodike vjetore dhe të përdorur si burim për blerje apartamenti në vitin 2009.

110. Për sa i përket faktit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, kontratën paraprake të sipërmarrjes, lidhur mes saj dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 25.8.2006, në vlerësimin të Komisionit, zbatimi i ligjit nr. 9049, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, përcakton detyrimin e subjekteve vetëdeklaruese të deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre e të interesave private në datën 31 dhjetor, të çdo viti përkatës dhe jo detyrimisht çdo ndryshim të këtyre të drejtave përgjatë vitit kalendarik. Në këtë kuptim, rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, kontratën e sipërmarrjes së nënshkruar mes saj dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në datën 9.10.2009, si burimet e financimit të kësaj kontrate, e cila ka përcaktuar në vijim të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe të subjektit, duke qartësuar marrëdhënien me bankën dhe vendosur këtë apartament si kolateral për kredinë e marrë në “Raifeisen Bank” në vitin 2006

dhe duke përmbushur qëllimin e subjektit të rivlerësimit për blerjen e një apartamenti banimi pranë vendit të punës.

111. Në konkluzion, Komisioni ka çmuar se veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e të vetmes banesë që subjekti rezulton të ketë në pronësi të saj, nuk përbëjnë një aktivitet i cili duhet të konsiderohet se ka afektuar me paligjshmëri burimin e krijimit të pasurisë shtëpi banimi, të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

112. Komisioni vlerëson se pasaktësitë e konstatuara gjatë deklarimeve periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit nuk konstatohet se mund të kenë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo deklarimi të rremë lidhur me ligjshmërinë e burimeve të përdorura prej saj në blerjen e kësaj pasurie.

113. Në vlerësimin të Komisionit, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji<sup>33</sup>, pasaktësitë në deklarime nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla, që të formojnë bazën e duhur ligjore për shkarkim. Ky qëndrim, i mbështetur në analizim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 që të drejtojnë te neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë edhe me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si një parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi, përpjekjet e subjektit për defektimin e deklarimeve të tij në deklaratën “Vetting”, parakusht që përjashton pasaktësitë në deklarime, si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklarime të rreme dhe fshehje e pasurisë.

114. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, të dhuruar nga prindërit në vitin 2009, duke provuar mundësitë e tyre financiare për blerjen e apartamentit në Durrës në vitin 2003 dhe detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e tij në vitin 2006.

115. Duke përdorur konkluzionet e mësipërme, Komisioni kreu analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë apartamentet banimi në Tiranë, duke marrë në konsideratë kursimet e subjektit nga të ardhurat e tij, shumën e përfituar nga kredia në vitin 2006, si dhe shpjegimet gjatë parashtrimeve, lidhur me kursin e këmbimit të përdorur prej saj në konvertimin e kursimeve nga lekë në euro, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit përballon me burime të ligjshme pagimin e kësaj shume, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë e gjen këtë pasuri të ligjshme në kuptim të objektit dhe përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

116. Në vijim të hetimit administrativ ka rezultuar se në periudhën 1.3.2000 – 19.2.2004, subjekti ka punuar si gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. E pyetur për vendbanimin gjatë kësaj periudhe, ajo ka deklaruar se ka marrë me qira një apartament 1+1, të mobiluar, të ndodhur në lagjen e re, Përmet. Këto shpenzime janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit.

117. DPSHTRr-ja<sup>34</sup> konfirmon se subjekti nuk ka automjet të regjistruar. Po ashtu, nga verifikimi në faqen e AMF-së nuk kanë rezultuar të dhëna për subjektin e rivlerësimit.

118. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni, drejtuar institucioneve të tjera private e publike nuk rezultuan të dhëna apo *indicie* lidhur me subjektin e rivlerësimit.

<sup>33</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019.

<sup>34</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 27.2.2019.

119. Në deklaratën e pasurisë “Vetting” babai i subjektit të rivlerësimit, z. B. D., (person i lidhur) ka deklaruar:

**1. Apartament me sip. 110 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, p. \*\*\*, Durrës,** blerë me Kontratën e Shitjes me Kusht të datës 15.12.2006 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 5.300.000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 130 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, lagjja nr. \*\*\*, p. \*\*\*, k. \*\*\*, Durrës, me Kontratën e Shitjes me Kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.12.2006, në shumën 9.000.000 (nëntë milionë) lekë.

Analiza e kësaj pasurie është kryer më lart për shkak të dhurimit të shumës prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro vajzës së subjektit, nga të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2006.

**2. Dyqan (ambient shërbimi) me sip. 30.99 m<sup>2</sup>,** përfituar me Kontratën e Dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.1.1998, shtetasit M., Sh., A., dhe S. K., (tezja e subjektit dhe familjarët e saj) i dhurojnë babait të subjektit të rivlerësimit, z. B. D., apartamentin me sip. 62,99 m<sup>2</sup> dhe sip. truall 15,558 m<sup>2</sup> (pak më shumë se 15 m<sup>2</sup>), në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës. Shtetasit M., Sh., A., dhe S., K., këtë apartament e kishin fituar me Kontratën e Këmbimit nr. 388 rep., nr. 241 kol., datë 23.1.1998, me të cilën këmbejnë apartamentin e fituar nga privatizimi në rrugën “\*\*\*\*”, me sip. 67.29 m<sup>2</sup>, Durrës, me apartamentin në rrugën “\*\*\*\*”, Durrës me sip. 62.99 m<sup>2</sup> dhe sip. truall 15.558 m<sup>2</sup>, që ishte në pronësi të shtetasve T., dhe T. K. Sipas kontratës së shitblerjes me ndërmarrjen Komunale Banesa të datës 13.10.1993, shtetasit T., dhe T. K., blejnë apartamentin me sip. 62,99 m<sup>2</sup>, dhe truall me sip. 15,558 m<sup>2</sup>.

Me Kontratën e Dhurimit nr. \*\*\*, datë 10.8.1998 babai i subjektit, z. B. D., i dhuron shtetasit A. G., (baxhanakut) sipërfaqen 32 m<sup>2</sup>.

ZVRPP-ja Durrës vendos në dispozicion kartelën e pasurisë, njësi me sip. 30.99 m<sup>2</sup>, të regjistruar në emër të babait të subjektit, z. B. D. Te kjo kartelë gjendet përshkrimi për pasurinë, që në bazë të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.12.2011<sup>35</sup> dhe lejes së shfrytëzimit nr. \*\*\*, datë 9.1.2011 ndryshohet destinacioni nga apartament në njësi. KRRT-ja e Bashkisë Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.13.12.2010 vendosi që subjektit ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k. t’i miratohet kërkesa për leje ndërtimi në pronë të familjes së z. B. D., për objektin “Ndryshim destinacioni nga ambient banimi/ambient shërbimi” me sipërfaqe ndërtimi 30.99 m<sup>2</sup>. Lidhur me shkaqet e dhurimit, subjekti ka sqaruar se ka qenë vullneti i tezes së saj t’ua dhurojë këtë pasuri dy motrave<sup>36</sup>.

Në përfundim të hetimit nuk u ngritën dyshime lidhur me këtë pasuri.

120. Ministria e Drejtësisë<sup>37</sup> vendos në dispozicion listën e veprimeve (akteve noteriale) për periudhën 1.3.2013 – 4.4.2019, të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur me të, nga ku konstatohet se babai i subjektit të rivlerësimit, z. B. D., në datën 12.1.2016 ka lidhur kontratë shkëmbimi përpara noteres G. B.

121. Lidhur me këtë kontratë, subjekti rivlerësimit shpjegon se ka marrë Kontratën e Shkëmbimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë shërbimi 2.12.2015, datë arkivimi në Regjistrin Noterial Shqiptar datë 12.1.2016, notere G. A. B., nga e cila rezulton se ajo është një kontratë e lidhur ndërmjet investitorit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe pronarit të truallit, shtetas N. M. Referuar kësaj kontrate, babai i subjektit të rivlerësimit është vetëm përfaqësues me prokurë i shtetas N. M., (për efekt të marrëdhënieve miqësore dhe për faktin se kjo shtetase është rezidente në Itali). Z.

<sup>35</sup> Leja e ndërtimit është miratuar nga KRRT-ja e bashkisë me vendimin nr. 7, datë 13.12.2010.

<sup>36</sup> Shihni shpjegimet e datës 25 mars 2020.

<sup>37</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2019.

B.D., nuk është palë kontraktore, por thjesht përfaqësues me prokurë dhe nuk ka pasur asnjë lloj përfitimi nga kryerja e këtij veprimi noterial dhe kjo del edhe nga përmbajtja e kontratës.

122. Në vijim, subjekti rivlerësimit ka paraqitur Kontratën e Shkëmbimit nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë shërbimi 2.12.2015, lidhur përpara noterës G. B., si dhe vërtetim nxjerrë nga arkiva noteriale nr., \*\*\* rep., datë 6.5.2020, lëshuar nga e njëjta notere.

123. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar ka rezultuar se z. B. D., ka pasur këto llogari bankare:

- a) llogari rrjedhëse nr. \*\*\*, në monedhën lekë, në bankën “Societe Genarale Albania”, ku ka përfituar disa pagesa në periudhën 2006 – 2007, si dhe dy depozita bankare të lidhura me këtë llogari [trajtuar më sipër, te burimi i dhurimit të shumës 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në vitin 2009];
- b) llogari rrjedhëse nr. \*\*\*, në monedhën euro, në BKT, në të cilën ka përfituar një pagesë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, në datën 13.8.2013 (trajtuar më sipër);
- c) llogari rrjedhëse nr. \*\*\*, në monedhën lekë në “ProCredit Bank”, aktive në periudhën 7.2.2007 – 14.7.2011, në të cilën z. D., ka depozituar dhe transferuar në mënyrë periodike shuma modeste monetare [deri në 43.000 (dyzet e tre mijë) lekë];
- ç) llogari rrjedhëse nr. \*\*\*, në monedhën euro në “ProCredit Bank”, aktive në periudhën 7.2.2007 – 22.4.2008, në të cilën z. B. D., ka përfituar nëpërmjet një transferte në datën 7.2.2007 shumën 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro, të cilën e ka transferuar në të njëjtën datë jashtë kësaj llogarie (nuk identifikohet dërguesi i kësaj shume dhe as përfituesi i saj).

124. Në vijim, subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me shumën 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro të transferuar në llogarinë e saj, si dhe burimin e të ardhurave, e cila ka shpjeguar se kjo shumë është transferuar në llogarinë e babait të subjektit nga shtetasi F. F., dhe po në të njëjtën ditë ai e ka kaluar në llogarinë rrjedhëse të shtetasit Z. F., (vëllai i shtetasit F. F.). Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.4.2019, me deklarues shtetasit F. F., B. D., dhe O. V., shtetasi F. F., ka deklaruar, ndër të tjera, (citoj): “... unë këtë shumë prej 84.000 (tetëdhjetë e katër mijë) euro, do t’ia ktheja vëllait tim, Z. F. Në fillim të vitit 2007, shkova te banka për të transferuar eurot, mbasi kisha fonde në llogarinë time personale, në këtë moment banka më tha që mbi 30.000 (tridhjetë mijë) euro, nuk ke të drejtë transferimi. Atëherë, për ta zgjidhur këtë problem unë i kalova në llogari personale djalit të tezes sime, z. B. D., dhe shokut tim O. V., secilit prej 28.056 (njëzet e tetë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) euro, të cilët këto euro do t’ia transferonin z. Z. F., në Itali, për shlyerjen e borxhit tim personal”.

125. Bashkëlidhur kësaj deklarate noteriale janë edhe fletët “lëvizje llogarie/Account Statement”, 3 (tre) copë, të marra në datën 16.4.2019 nga “ProCredit Bank”, mbi logaritë rrjedhëse të shtetasve F. F., B. D., dhe O. V., ku pasqyrohen transaksionet e kryera. Nga këqyrja e tyre rezulton se në të njëjtën datë, 7.2.2007, z. F. F., ka kaluar eurot në llogaritë e shtetasve B. D., dhe O. V., dhe ata në të njëjtën datë i kanë kaluar në llogarinë rrjedhëse të shtetasit Z. (Z.) F., madje duke qenë se këto transaksione kryheshin për shtetasin F. F., ai i ka transferuar edhe paratë që do të shërbenin si komision për kalimin te z. Z. F., shumën prej 56 (pesëdhjetë e gjashtë) euro.

126. Për të provuar të njëjtin fakt, përfituesi, shtetasi Z. (Z.) F., ka lëshuar Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 13.8.2019, ku konfirmon sa më sipër.

127. Nga hetimi i Komisionit nuk kanë rezultuar dyshime për hetime të mëtejshme lidhur me babin e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të lidhen me subjektin e rivlerësimit znj.Etleva Deda.

128. Në deklaratën e pasurisë “Vetting” nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. I. D., (person i lidhur), ka deklaruar **1/7 pjesë të truallit me sip. 300 m<sup>2</sup>**, nr. pasurie \*\*\*, z.k. \*\*\*, me vendndodhje në rrugën Plazh/\*\*\*, Durrës, pasuri e fituar me trashëgimi ligjore nga babai i saj, z. M. K. Gj. Sipas Certifikatës së Pronësisë, lëshuar në datën 20.10.2016, nga ZVRPP-ja Durrës, ky truall rezultoi i regjistruar në emër të babait të nënës së subjektit, z. M. Gj.

Nga shqyrtimi i praktikës së ZVRPP-së Durrës<sup>38</sup> rezultoi se z. M. Gj., e ka fituar truallin me sip. prej 300 m<sup>2</sup> me Kontratën e Dhurimit datë 3.6.1997, nga i biri i tij, z. N. Gj. Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 16.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëna e subjektit është një nga trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë me 1/7 pjesë<sup>39</sup>. Trashëgimtarët ligjorë kanë emëruar me prokuror nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.2.2005, si përfaqësues vëllanë e tyre, z. N. Gj., që të lidhë aktmarrëveshjen me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e një objekti ndërtimi. Në emër të trashëgimtarëve të z. M. Gj., në datën 14.2.2005, z. N. Gj., ka lidhur Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga z. E. L.

Nëna e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën “Vetting”, shprehet, ndër të tjera se: “... edhe pse ndërtimi ka përfunduar, nuk ka përfutur pjesë takuese, pasi objekti nuk është legalizuar, si dhe nuk janë kryer veprime për pjesëtimin e pasurisë (referojuni deklaratës së pasurisë së N. Gj., me funksion prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë).

129. Nga hetimi i Komisionit nuk kanë rezultuar dyshime për hetime të mëtejshme lidhur me nënën e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të lidhen me subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Deda.

130. Në deklaratën e pasurisë “Vetting” motra e subjektit të rivlerësimit, znj. L. D., (person i lidhur), ka deklaruar **Automjet tip “Citroen Picasso”** me targa \*\*\*, viti i prodhimit 2007, sipas Certifikatës së Pronësisë, lëshuar nga DPSHTRr-ja, në datën 23.6.2011. Ky automjet është blerë në shumën 7.100 (shtatë mijë e njëqind) euro + taksa doganore 269.146 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë. Pagesa është kryer nga prindërit, B., dhe I. D., me kursimet familjare, pasi ky automjet shërben edhe në funksion të aktivitetit të tyre privat.

DPSHTRr-ja<sup>40</sup> konfirmon se automjeti me targa \*\*\* është në pronësi të shtetasës L. D., si dhe vendos në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e tij. Sipas faturës së datës 13.9.2010, znj. L. D., e ka blerë automjetin tip “Citroen Picasso”, viti i prodhimit 2007, në vlerën 7.100 (shtatë mijë e njëqind) euro në Gjermani, ndërsa shpenzimet doganore janë në vlerën 269.146 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë.

Referuar aktivitetit të tyre tregtar, konstatohet se prindërit kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti.

131. Ministria e Drejtësisë<sup>41</sup> vendos në dispozicion listën e veprimeve (akteve noteriale) për periudhën 1.3.2013 – 4.4.2019, të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur me të, nga ku konstatohet se motra e subjektit të rivlerësimit, në datën 9.8.2013 ka lidhur kontratë huapërdorje përpara noteres M. N.

Lidhur me këtë kontratë, subjekti shpjegon se: “Sipas Kontratës Huapërdorje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9 gusht 2013, të përpiluar përpara noteres M. N., ime motër, L. D., me cilësinë e huadhënëses, u ka dhënë të drejtën të përdorin automjetin e saj, pa afat, pa kundërshtim dhe me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, motrës sonë A. A. (D.) dhe bashkëshortit të saj A. A., (për kohën kur ata vijnë në Shqipëri)”.

<sup>38</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2017, nga ZVRPP-ja Durrës, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>39</sup> Z. M. Gj., ka ndërruar jetë më 7.3.2001.

<sup>40</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2019.

<sup>41</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2019.

Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar Kontratën e Huapërdorjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9 gusht 2013, të përpiluar përpara noteres M. N.

132. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar rezulton se znj. L. D., ka pasur llogaritë bankare si vijon: (1) llogari page nr. \*\*\*, në lekë në BKT<sup>42</sup>, të çelur në datën 17.9.2015, në të cilën ka përfiturar pagën nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në periudhën 17.9.2015 – 25.16.2016; (2) llogari page me nr. \*\*\*, në monedhën lekë në “Credins Bank”<sup>43</sup> sh.a., të çelur në datën 1.7.2016, në të cilën ka përfiturar pagën nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, në periudhën 1.7.2016 – 31.12.2018.

133. Në përfundim të hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka rezultuar se deklaratimet e kryera përputhen me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe nuk u konstatuan problematika apo *indicie* për hetime të mëtejshme për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit.

### ANALIZA FINANCIARE

134. Në përgatitjen e kësaj analize është përfshirë vetëm subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga viti 2003. Megjithatë ka qenë në të njëjtin trung familjar me prindërit dhe motrën L. D., ajo nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhurat, pasuritë dhe likuiditetet e tyre.

135. Lidhur me pasqyrimin e likuiditeteve *cash*, ndër vite, analiza financiare përfshin kursimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore. Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë nëse shumat *cash* të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2003 – 2016 janë shtesa apo gjendje të likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti kalendarik. Subjekti ka konfirmuar<sup>44</sup> deklaratimet e kryera në deklaratat periodike vjetore dhe ka shpjeguar se kursimet e deklaruara pasqyrojnë kursimet nga paga, nga 1 janari i vitit për të cilin ka deklaruar deri më 31 dhjetor të atij viti. Ato kursime janë mbartur në vitin pasardhës, por në kushtet kur i ka deklaruar në vitin e krijimit, nuk i ka rideklaruar përsëri si gjendje *cash*.

136. Duke krahasuar deklaratimet periodike të subjektit lidhur me gjendjen *cash*, si dhe deklarimin e saj në deklaratën “Vetting” vërehet se shpjegimet e dhëna prej saj përputhen<sup>45</sup>, por deklaratimet në deklaratat periodike vjetore vërehet se nuk janë në harmoni me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar. Në analizën financiare është përfshirë shuma e kredisë prej 5.000.000 (pesë milionë) lekësh, si gjendje *cash* në banesë.

137. Komisioni ka përllogaritur shpenzimet jetike vjetore, sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja,<sup>46</sup>

<sup>42</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., nga BKT-ja.

<sup>43</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2019, nga “Credins Bank” sh.a.

<sup>44</sup>Pyetësori datë 20.11.2019, përgjigjja nr. 1.

<sup>45</sup>Për më shumë referojuni shpjegimeve të subjektit në pyetësorët gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

<sup>46</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019, nga ILDKPKI-ja; ky institucion konfirmoi se shpenzimet jetike i referohen treguesve statistikorë të përllogaritur nga INSTAT-i dhe ka vënë në dispozicion vlerat e konsumit vjetor/frymë për periudhën 2003 – 2016. Nga shqyrtimi i këtyre të dhënave rezulton se për vitin 2007 është përdorur një vlerë shumë e lartë krahasuar 136,620 lekë. Për këtë arsye, në analizën financiare të subjektit, për vitin 2007 është përdorur vlera e shpenzimeve jetike të vitit 2008.



## Analiza financiare 2003 – 2016

Subjekti i Rivlerësimit <b>ETLEVA DEDA</b>	Para vitit 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	0	0	0	6,760	6,103,345	490,304	331,843	2,948,570	504,397	2,218,993	409,462	1,219,321	-1,196,204	-387,492	-4,345	12,644,954
Shtëpi banimi me sip. 115 m <sup>2</sup> , rruga "****", Tiranë								9,876,240		2,766,000						12,642,240
Diferencë Likuiditeti (Lik. të vitit Aktual - Lik. të vitit Paraardhës)		0	0	6,760	6,103,345	490,304	331,843	-6,927,670	504,397	-547,007	409,462	1,219,321	-1,196,204	-387,492	-4,345	2,714
<b>LIKUIDITETE (FUND VIII Dok.)</b>	0	0	0	6,760	6,110,105	6,600,409	6,932,252	4,582	508,979	-38,027	371,435	1,590,756	394,551	7,059	2,714	
<b>DETYRIME</b>	0	0	0	0	4,927,866	-294,002	-302,994	-312,159	-321,653	774,963	-221,395	-1,482,999	-392,537	-409,910	-414,232	1,550,949
Kredi pranë bankës RAIFFEISEN për blerje apartamenti viti 2006					4,927,866	-294,002	-302,994	-312,159	-321,653	-331,437	-341,518	-351,905	-362,609	-373,638	-385,002	1,550,949
Kredi pranë bankës RAIFFEISEN për blerje frigoriferi viti 2012											120,122	-24,693	-29,928	-36,272	-29,229	0
Hua nga znj. H. D.										1,106,400		-1,106,400				0
<b>PASURINETO (PASURI - DETYRIME)</b>	0	0	0	6,760	1,175,479	784,306	634,838	3,260,728	826,051	1,444,030	630,857	2,702,319	-803,668	22,417	409,887	11,094,004
<b>TE ARDHURA të dokumentuara</b>	0	607,643	1,387,860	1,104,857	1,180,492	1,473,568	1,280,899	3,389,140	1,483,218	2,284,988	1,338,587	3,407,830	1,677,263	1,790,783	1,646,586	24,053,714
Të ardhura nga paga si gjyqtare		607,643	1,387,860	1,104,857	1,180,492	1,223,568	1,280,899	1,331,590	1,483,218	1,731,788	1,338,587	1,479,942	1,677,263	1,790,783	1,646,586	19,265,076
Të ardhura nga shitja e apartamentit në rr. "****", Durrës						250,000										250,000
Dhuratë likuiditete nga prindërit në vitin 2009								2,057,550								2,057,550
Dhuratë nga babai, z. B. D.										553,200						553,200
Të ardhura nga shitja e pasurisë në shërbimi në Durrës												1,927,888				1,927,888
Dhuratë likuiditete nga prindërit në vitin 2017																0
Dhuratë likuiditete nga të afërmit në vitin 2017																0
Numri i personave		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	
<b>SHPENZIME</b>	0	153,964	103,964	109,557	146,877	280,435	300,547	317,746	256,584	243,001	755,845	514,424	1,307,546	373,059	290,104	5,153,653
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI - INSTAT		93,964	93,964	109,557	109,557	136,620	136,620	136,620	136,620	136,620	139,548	141,024	219,998	224,276	235,092	2,050,080
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS			0	0	0	0	29,054	55,468	3,800	0	82,589	55,826	126,800	75,019	0	428,555
Shpenzime qiraje Përmet (2003 - 2004)		60,000	10,000													70,000
Shpenzime për interesat bankare kredia 5,000,000 lekë për apartamentin					37,320	143,815	134,873	125,659	116,164	106,381	96,300	85,912	75,209	64,179	52,815	1,038,626
Shpenzime për interesat bankare kredia lekë për blerje frigoriferi											8,458	21,162	15,928	9,584	2,197	57,329
Shpenzim për blerje frigoriferi në vitin 2012											123,950					123,950
Shpenzim për mobilimin e apartamentit në Tiranë											305,000	210,500	210,500			726,000
Shpenzime mjekësore në Turqi në vitin 2014													659,112			659,112
Shpenzime mjekësore në spitalin "****" në vitin 2017																0
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT (sipas vërtetimeve bankare)</b>	0	0	0	6,760	6,110,105	6,600,409	6,932,252	4,582	508,979	-38,027	371,435	1,590,756	394,551	7,059	2,714	0
Llogari page banka Raiffeisen në LEK		0	0	6,760	110,105	409	32,252	4,582	8,979	-38,027	21,435	-15,452	43,976	7,059	2,714	
Llogari rrjedhëse banka Procredit në LEK			0	0	5,000,000	0										
<b>Gjendje CASH-i deklaruar ne DPV</b>		0	0	0	1,000,000	6,600,000	6,900,000	0	500,000	0	350,000	1,606,208	350,575	0	0	0
Diferencë Likuiditeti (Lik. të vitit Aktual - Lik. të vitit Paraardhës)		0	0	6,760	6,103,345	490,304	331,843	-6,927,670	504,397	-547,007	409,462	1,219,321	-1,196,204	-387,492	-4,345	
<b>Analiza deklaruar</b>																
Analiza dokumentuar (Të ardhura - Pasuri Neto - Shpenzime)	0	453,679	1,283,896	988,540	-141,864	408,827	345,514	-189,335	400,583	597,957	-48,115	191,086	1,173,385	1,395,307	946,595	7,806,056
Aftesia reale per te kursyer					858,136			210,665								

138. Si rezultat i balancës negative financiare në vlerën -379.314 (minus treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e katërbëdhjetë) lekë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit.

139. Në lidhje me balancën negative financiare, subjekti shpjegon se vlera -141.864 (minus njëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë (viti 2006) është si pasojë e pasaktësisë në deklarin e kursimeve nga paga për vitin 2006, ndërsa balanca negative financiare për vitin 2009, në vlerën -189.355 (minus njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, lidhet me kursin e këmbimit lekë/euro, në momentet më të volitshme, sikurse vepronjë thuajse të gjithë shtetasit (shpjeguar edhe më lart në këtë vendim).

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme.

Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme dhe nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë të besueshme dhe shteruese informacionin e kërkuar.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

140. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport në datën 30.10.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Bedri Deda. Më tej, raporti nr. \*\*\*, datë 30.10.2017 është deklasifikuar plotësisht.

141. Komisioni i është drejtuar me shkresë DSIK-së, duke i kërkuar përditësimin e informacionit. Në përgjigjet e ardhura nuk ka të dhëna apo *indicie* të reja për këtë subjekt.

142. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme mbi të dhëna ose *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, të përfshirë drejtpërdrejt në veprime të dyshimta, si dhe informacione mbi kontakte të papërshtatshme.

Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para nëpër rrethe, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda informojnë, ndër të tjera, se ndaj subjektit nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzim, procedim penal apo disiplinor në ngarkim të saj.

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën e datës 5.3.2019, informon se nuk ka ardhur asnjë informacion nga agjencitë ligjzbatuese, për implikim të saj në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës.

143. Gjatë procesit të hetimit, Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Gjithashtu, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

144. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional.

145. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ajo ka njohuri për procedurën e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore penale në funksion të zgjidhjes së çështjes, si dhe i kushton rëndësi kërkimeve procedurale në raport me rregullat procedurale dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi to.

Gjyqtarja ka njohuri mbi parimet e përgjithshme të së drejtës. Në këtë drejtim, ajo përdor edhe referenca nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarja Etleva Deda ka aftësi në arsyetimin ligjor. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar me format unik me paragrafë të panumërtuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të subjektit Etleva Deda plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal.

146. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Etleva Deda nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

147. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Etleva Deda përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

148. Në Komision janë regjistruar katër denoncime, nga të cilat pas vlerësimit të kryer nga Komisioni nuk u gjetën *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit, apo të dhëna të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale të saj.

## **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.6.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**

**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Relatore**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Anëtare**

Sekretare gjyqësore

Fiorela Mandro